



Radiotelevizioni i Kosovës
Rr. "Xhemajl Prishtina", nr. 12
Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefon: +381 38 230 119
Tel./fax: +381 38 235 336

BORDI I DREJTORËVE

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2010

Prishtinë, 2011

1. PËRMBAJTJA

1.	PËRMBAJTJA.....	2
2.	FJALA E KRYETARIT TË BORDIT	4
3.	FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM.....	6
4.	MISIONI.....	8
5.	STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	9
5.1.	BORDI I DREJTORËVE I RTK-SË	9
5.2.	MENAXHMENTI I LARTË I RTK-SË	9
6.	TELEVIZIONI.....	10
6.1.	HYRJE	10
6.2.	SHIKUESHMËRIA GJATË VITIT 2010.....	11
6.3.	STRUKTURA PROGRAMORE DHE PRODHIMI	12
6.4.	PROGRAMI INFORMATIV	13
6.4.1.	DHOMA E LAJMEVE	13
6.4.2.	PROGRAMI I MËNGJESIT	17
6.4.3.	REDAKSIA E AKTUALITETEVE.....	17
6.4.4.	"DHJETË MINUTA"	17
6.4.5.	"DEBAT"	17
6.4.6.	"SUBVENCION"	18
6.4.7.	"EVROPA MË AFËR"	18
6.4.8.	EMISIONET E TJERA	18
6.4.9.	PROJEKTET E TJERA TË TVK-SË GJATË VITIT 2010	19
6.4.10.	NGJARJE TË TJERA TË JASHTËZAKONSHME.....	20
6.4.11.	REKAPITULLIM I TË ARRITURAVE DHE NGECJEVE TË SEKTORIT INFORMATIV NË TVK - RTK.....	20
6.5.	PROGRAMI KULTUROR, ARSIMOR, DOKUMENTAR DHE PËR FËMIJË (PKADF)	21
6.5.1.	PROGRAMI ARSIMOR.....	21
6.5.2.	PROGRAMI PËR FËMIJË.....	21
6.5.3.	PROGRAMI I KULTURËS.....	21
6.5.4.	PROGRAMI DOKUMENTAR	22
6.5.5.	PROGRAMI I DRAMËS.....	22
6.6.	PROGRAMI ARGËTUES, MUZIKOR DHE SPORTIV (PAMS)	23
6.6.1.	REDAKSIA E MUZIKËS.....	23
6.6.2.	REDAKSIA E ARGËTIMIT	24
6.6.3.	REDAKSIA E TË RINJVE	24
6.6.4.	REDAKSIA PËR FILMA TË HUAJ DHE SERIALE	24
6.6.5.	REDAKSIA E SPORTIT.....	25
6.7.	SHËRBIMI PROGRAMOR I TELEVISIONIT TË KOSOVËS.....	26
6.7.1.	HYRJE	26
6.7.2.	DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE TË HUAJA	26
6.7.3.	NJËSIA E POST-PRODUKSIONIT.....	28
6.7.4.	NJËSIA E TITRIMIT	29
6.7.5.	NJËSIA E KËMBIMIT - EVN.....	29
6.7.6.	NJËSIA E REGJISË SË DITËS – MCR	31
6.7.7.	ARKIVI.....	31
6.7.8.	NJËSIA E SKEMËS PROGRAMORE.....	31
6.7.9.	NJËSIA E PROMOCIONIT	32
6.7.10.	NJËSIA E STATISTIKËS DHE E HULUMTIMIT PROGRAMOR.....	32
6.8.	SEKTORI I TEKNIKËS NË RTK-TELEVIZION	33
6.8.1.	NJËSIA E TRANSMETIMIT	34
6.8.2.	TEKNIKA E STUDIOS.....	35
6.8.3.	SEKTORI I TRANSMETIMEVE TË JASHTME.....	36
6.8.4.	NJËSIA E ENERGJETIKËS.....	37
6.9.	TV PRODUKSIONI	39
6.9.1.	NUMRI I EMISIONEVE TË REALIZUARA.....	39
6.9.2.	ORËT E REALIZUARA.....	39

6.9.3.	PROGRAMET INFORMATIVE - ORËT E REALIZUARA	40
6.9.4.	ORËT E REALIZUARA / PKDAF/ PAMS / INFORMATIKA / LAJMET	40
6.9.5.	DIZAJNI GRAFIK.....	40
6.9.6.	SKENOGRAFIA.....	40
7.	RADIO KOSOVA DHE RADIO BLUE SKY	41
7.1.	HYRJE	41
7.2.	RADIO KOSOVA	41
7.2.1.	PROGRAMI INFORMATIV	41
7.2.2.	EMISIONE DHE PROGRAME TË TJERA.....	43
7.2.3.	PROGRAMI NË GJUHËT E KOMUNITETEVE.....	44
7.2.4.	PROGRAMI NË GJUHËN SERBE.....	44
7.2.5.	PROGRAMI NË GJUHËN TURKE.....	44
7.2.6.	PROGRAMI NË GJUHËN BOSHNJAKE.....	45
7.2.7.	PROGRAMI NË GJUHËN ROME.....	45
7.3.	RADIO BLUE SKY.....	46
7.3.1.	PROGRAMI INFORMATIV	46
7.3.2.	EMISIONE DHE PROGRAME TË TJERA.....	46
7.4.	TEKNIKA – RTK RADIO	47
8.	UEB-FAQJA E RTK-SË	48
9.	SHËRBIMET E PËRBASHKËTA	49
9.1.	SHËRBIMI ADMINISTRATIV/KADROVIK RTK-TV	49
9.2.	SHËRBIMI ADMINISTRATIV/KADROVIK NË RTK-RADIO.....	54
9.3.	SHËRBIMI I TI-SË	56
9.3.1.	NJËSIA E TI-SË NË RADIO	56
9.3.2.	NJËSIA E TI-SË NË TV.....	57
9.3.3.	ZHVILLIMET NË TI GJATË VITIT 2010	58
9.3.4.	NJËSIA E UEBIT	59
9.4.	ZYRA LIGJORE.....	61
9.5.	NJËSIA E ARSIMIMIT DHE TRAJNIMEVE.....	63
9.5.1.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	63
9.5.2.	ARSIMIMI 2010.....	63
9.5.3.	TRAJNIMET.....	63
10.	DEPARTAMENTI I PROKURIMIT.....	66
11.	REVIZIONI I BRENDSHËM.....	67
12.	FINANCAT.....	68
12.1.	TË HYRAT DHE SHPENZIMET E RTK-SË PËR VITIN 2010	68
12.1.1.	TË HYRAT	68
12.1.2.	SHPENZIMET.....	69

2. FJALA E KRYETARIT TË BORDIT

Shqyrtimi i kujdesshëm dhe i paanshëm i Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës bën të vërehen lëvizje serioze në drejtimin e duhur në punën e transmetuesit të vetëm publik në vend. Angazhimi i shtuar për rritjen e shkallës së profesionalizmit, përmbushja e obligimeve ligjore të RTK-së dhe shfrytëzimi më i mirë i kapaciteteve njerëzore dhe tekniko-teknologjike janë paradigma e punës së RTK-së gjatë vitit 2010. Arsyet për këtë qëndrojnë në disa veprime që janë ndërmarrë nga Bordi i Drejtorëve i RTK-së.

Bordi i Drejtorëve i Radiotelevizionit të Kosovës në kuadër të prioriteteve të përcaktuara është orientuar në këto pika:

1. Gjetja dhe ofrimi i alternativave për sigurimin e financimit të qëndrueshëm – me ç’rast u kemi ofruar palëve të interesuara (Kuvendit të Kosovës përmes Komisioneve përkatëse funksionale, KPM-së, Qeverisë së Kosovës, Zyrës Ndërkombëtare Civile, OSBE-së etj) së paku pesë alternativa për financim të qëndrueshëm të RTK-së, jashtë Buxhetit të Republikës së Kosovës. Arsyja pse ende nuk ka një zgjidhje, qëndron te mosmiratimi i Ligjit për RTK-në në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, Kuvendi i Kosovës nuk ka pasë arritur t’i përgjigjet Gjykatës Kushtetuese lidhur me vendimin për pezullimin e mbledhjes së taksës prej 3.5 Euro përmes faturave të KEK-ut;
2. Zgjedhja dhe kompletimi i menaxhmentit – është kryer më sukses zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm , dy Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm, Drejtorit të Televizionit dhe Drejtorit të Radios. Ka mbetur pa u zgjedhur kryeredaktori, edhe pse konkursi për këtë pozitë është shpallur dy herë. Gjithashtu kanë mbetur pa u proceduar me konkurs pozitën për Udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta dhe Udhëheqësin e Financave. Me miratimin e statutit të ri të RTK-së dhe të Organogramit, është hapur rruga për shpalljen e pozitës Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta, në kuadër të të cilit shërbim do të jetë edhe Shërbimi Financiar;
3. Funkcionalizimi i kapaciteteve të brendshme njerëzore dhe teknologjike – është arritur përmes vendimit për eliminimin e aneks-kontratave dhe regjistrimit të gjithë teknikës, me ç’rast janë konstatuar edhe keqpërdorime dhe situata të neglizhencës;
4. Respektimi i ligjit për transmetuesin publik – me ç’rast për herë të parë në historinë 11 vjeçare të RTK-së veprat e produksioneve të jashtme janë blerë përmes tenderit publik, me çka është eliminuar monopoli i grupeve të caktuara dhe u është ofruar mundësia produksioneve të pavarura për të transmetuar produktet e tyre në RTK. Në këtë vazdhë për herë të parë pas shumë vjetësh RTK ka pranuar punëtorë të rinj (përfshirë edhe Shërbimin e ri të brendshëm të marketingut) përmes konkursit publik;

Së këndejmi, duke lënë ende mjaft vend për të qenë të kënaqur, Bordi i RTK-së konsideron se ndërmarrja e këtyre veprimeve ka ndikuar që punët në Radiotelevizionin e Kosovës të vihen në binarët e duhur, në mënyrë që transmetuesi publik të kryejë obligimet para ligjit dhe para qytetarëve të Kosovës, që janë audienca e tij. Bordi i RTK-së nuk do të lërë pa përmendur nevojën e rritjes së kontrollit të pavarur financiar në RTK dhe përmirësimin e cilësisë në disa fusha të prodhimit programor, si në programin për fëmijë dhe në atë kulturor.

Sigurisht që me këtë rast do të theksuar se statusi publik i RTK-së po rrezikohet nga mungesa e një financimi të qëndrueshëm, në pajtim me standardet dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. EBU disa herë ka tërhequr vërejtjen se forma e financimit ka rëndësi jetike për statusin e transmetuesit publik dhe për ruajtjen e pavarësisë editoriale të tij. Për këtë arsye, është Kuvendi i Kosovës, si themelues i RTK-së, ai që duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar miratimin e Ligjit të ri për RTK-në, i cili do të krijojë mundësi për financim të qëndrueshëm jo nga Buxheti i Kosovës, i cili është parakushti themelor për të siguruar pavarësi editoriale si një nga obligimet themelore të Radiotelevizionit të Kosovës. Mbetja e RTK-së nën mëshirën e projeksioneve buxhetore mund të interpretohet në raportet e pavarura të organizatave të ndryshme, si presion mbi politikat editoriale, pavarësisht se sa është kjo e saktë. Ky lloj presioni bashkë me veprimet e KPM-së për heqjen e marketingut në RTK gjatë gjashtë shtatë orësh të pikut të shikjueshmërisë, në kohën kur RTK nuk ka financim të qëndrueshëm, është një argument shtesë për nevojën e vënies së ligjshmërisë në këtë fushë.

Projekti i nisur tashmë për digjitalizimin e RTK-së dhe për instalimin e rrjetit të trasnemtimit digjital, është një ndërmarrje e menaxhmentit të RTK-së, që do ta zgjidhte edhe përfundimisht çështjen e financimit të qëndrueshëm të RTK-së, pa ngarkuar Buxhetin e Kosovës apo buxhetin e qytetarit të Kosovës, i cili ka të drejtë për informim të drejtë, të paanshëm dhe në kohën e duhur.

Prishtinë, 29 mars 2011

Prof. Ass. Dr. Rrahman Paçarizi
Kryetar i Bordit të Drejtorëve të RTK-së

3. FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Në vitin 2010 RTK-ja ka hyrë me lëndime serioze, siç është një Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (shtator 2009), me anë të të cilit ndërpritet mbledhja e taksës për financimin e RTK-së.

Janari i vitit 2010 e gjen RTK-në pa menaxhment të kompletuar. Që prej shtatorit 2009, në krye të RTK-së ishte një ushtrues detyre në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm. Pozita e Drejtorit të RTK-Televizionit ishte e zbrazët. Në pozitën e Drejtorit të RTK-Radios gjithashtu ishte një ushtrues detyre. Prej vitesh nuk ishte e plotësuar pozita e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm.

Në fund të muajit janar 2010 është plotësuar pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Në fillim të muajit mars 2010 janë plotësuar pozitat: Zv.drejtor i Përgjithshëm, Drejtor i RTK-Televizionit dhe Drejtor i RTK-Radios.

Në anën tjetër, me një vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, RTK-së i sigurohet një financim i përkohshëm gjashtëmujor, me çka sigurohen kushte minimale për funksionimin normal të transmetuesit të vetëm publik në vend.

Ky intervenim financiar nga Kuvendi i Kosovës dhe intervenimi tjetër për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010 ngre shqetësime për statusin e RTK-së. Financimi nga paraja e Buxhetit ngërthen më vete rrezikun e të qenit transmetues publik i pavarur.

Gjatë gjithë vitit 2010, strukturat drejtuese të RTK-së, përfshirë edhe Bordin e RTK-së, janë angazhuar në draftimin e Ligjit të RTK-së, i cili, veç tjerash, do të siguronte financim të qëndrueshëm dhe të pakontestueshëm të RTK-së.

Megjithatë, për shkak të shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës, Projektligji për RTK-në nuk arriti të procedohet në Kuvend.

Programi i Televizionit, programet e të dyja radiove dhe përmbajtja e ueb-faqes së RTK-së gjithsesi kanë qenë në fokus të drejtuesve të RTK-së. Me gjithë vështirësitë, konsideroj se është arritur që jo vetëm të ruhen, por edhe të avancohen ndjeshëm segmentet kryesore programore, siç janë programi informativ, debatues, e në veçanti krijimi i hapësirës programore për krijuesit vendës dhe inkurajimi i depërtimeve cilësore në afirmimin e vlerave kulturore e edukative.

Raporti vjetor i punës së RTK-së për vitin 2010 pasqyron vlerësimin e punës së njësive përbërëse të RTK-së nga ana e njerëzve që i kanë drejtuar sektorët përkatës. Ky raport përmban më vete edhe intencën për të vlerësuar objektivisht rezultatet e punës së të gjithë të punësuarve në RTK.

Gjithashtu, raporti pasqyron edhe një segment të rëndësishëm, vlerësimin e audiencës për programet e RTK-së (rezultatet e sondazhit). Por, ky vlerësim i audiencës nuk është i plotë, së paku nuk është i plotë për atë sa do të dëshironim ne. Sidoqoftë, Raporti vjetor 2010 konstaton të gjitha orët dhe minutat e programit të Televizionit, të dy radiove dhe të ueb-faqes së RTK-së.

Debati institucional dhe publik, të cilit do t'i nënshtrohet ky raport, do të nxjerrë vlerësimet më meritore për punën e RTK-së dhe kahet e zhvillimit të mëtejshëm të shërbimit të Transmetuesit Publik.

Sylejman Shaqiri,
Drejtore i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës

4. MISIONI

Misioni i RTK-së është që t'i ofrojë auditorit informim objektiv dhe të balancuar, program cilësor edukativ, kulturor dhe argëtues, si dhe të inkurajojë zhvillim harmonik të demokracisë dhe të tolerancës.

Në zbatimin e misionit të vet, RTK-ja ndjek këto parime dhe vlera:

- Lirinë e fjalës, të kreativitetit dhe të ndërgjegjes
- Pavarësinë
- Objektivitetin
- Korrektësinë
- Saktësinë
- Transparencën
- Respektimin e interesave dhe vlerave të shoqërisë
- Respektimin e dinjitetit njerëzor, të të drejtave individuale, të jetës private
- Informim të plotë
- Përgjegjësinë personale
- Tolerancën
- Opinionet e ndryshme

Me shfrytëzimin efektiv të kapaciteteve të veta, RTK-ja mëton të prodhojë program cilësor argëtues dhe arsimor, si dhe lajme objektive, duke iu shmangur propagandimit të çfarëdo lloj dhune, urrejtjeje dhe shkeljeje të normave të tjera etike.

5. STRUKTURA ORGANIZATIVE

5.1. BORDI I DREJTORËVE I RTK-SË

Dr. Rrahman Paçarizi - kryetar

Aleksandar Janicievic - nënkryetar

Ali Podrimja - anëtar

Arif Bozagji - anëtar

Shemsi Syla - anëtar

Lindita Tahiri - anëtare

Shukrije Gashi - anëtare

Naime Beqiraj - anëtare

Avni Abazi - anëtar

5.2. MENAXHMENTI I LARTË I RTK-SË

Drejtor i Përgjithshëm - Sylejman Shaqiri

Zv.drejtorë të Përgjithshëm - Anamari Repic & Mentor Shala

Drejtor i Televizionit - Bekim Hasani

Drejtor i Radios - Arben Fetoshi

Udhëheqëse e Resurseve Njerëzore dhe Punëve Ligjore - Elvana Prekazi

Udhëheqës i Financave - Bujar Spahiu

6. TELEVISIONI

6.1. HYRJE

RTK-Televizioni, gjatë vitit 2010, me gjithë vështirësitë e shumta dhe mungesën e planit të detajuar të punës, ka shënuar progres të kënaqshëm në përmbushjen e misionit të vet. Edhe bazuar në matjet e opinionit publik, gjatë këtij viti, RTK-Televizioni ka ruajtur shkallën e shikueshmërisë dhe ka forcuar shkallën e besueshmërisë së audiencës së vet.

Gjatë këtij viti, pavarësisht vështirësive dhe mungesës së kapaciteteve udhëheqëse në disa sektorë e njësi punuese, RTK-Televizioni ka arritur të shtojë cilësinë e programit të prodhuar.

Vlen të theksohen arritjet në Programin Informativ, si dhe në Programin Argëtues, Muzikor dhe Sportiv, kurse mbetet të ndërhyhet për të garantuar sasi dhe cilësi në Programin Kulturor, Edukativ dhe për Fëmijë.

Përgjithësisht, zhvillime më pozitive janë arritur në pjesën e Programit Informativ dhe emisioneve muzikore-argëtuese, kurse në pjesët e tjera programore janë evidente ngecje që reflektojnë nivel jo të kënaqshëm të përkushtimit, përgjegjësisë dhe profesionalizmit.

Gjatë vitit 2010, në RTK-Televizion është menaxhuar me sukses tenderi/konkursi për blerjen e veprave audio-vizuele të producentëve të pavarur, si dhe është ndërhyrë me ndryshime në skemën programore.

Mbetet problematik Sektori i Teknikës, për shkak të nevojave të mëdha për investime, si dhe pamundësisë së RTK-së për t'i përmbushur ato kërkesa. Por, ndërkohë, gjatë vitit 2010 ka filluar dhe po vazhdon me sukses procesi i përgatitjeve për realizimin e kalimit nga sistemi analog në sistemin digjital të transmetimit.

Gjatë vitit 2010, janë evidentuar disa mangësi organizative, të cilat me kompletimin e stafit menaxherial, me zbatimin e ndryshimeve në organogram, si dhe me respektimin e akteve rregullative të RTK-së e me përkushtimin e punonjësve, shpresohet se do të tejkalohen në vitin vijues.

6.2. SHIKUESHMËRIA GJATË VITIT 2010

Televizioni i Kosovës, gjatë vitit 2010, ka qenë televizioni më i shikuar dhe më i besuar në Kosovë (sipas hulumtimeve të "Index Kosova").

Në vazhdim do të shihni tabelën e shikueshmërisë së përgjithshme për vitin 2010:




Fig.1 Rezultatet e shikueshmërisë sipas hulumtimit të "Index Kosova"

6.3. STRUKTURA PROGRAMORE DHE PRODHIMI

Objektivat e parapara lidhur me strukturën programore të Televizionit të Kosovës, gjatë vitit 2010, janë realizuar në tërësi.




Fig2. Struktura e programeve të Televizionit të Kosovës




Fig3. Prodhimi dhe transmetimi i programeve

6.4. PROGRAMI INFORMATIV

Viti 2010, për Programin Informativ të Televizionit të Kosovës (RTK), ka qenë viti kur janë shtuar përpjekjet për rritje të cilësisë në servimin e informacionit për opinionin, e po ashtu është rritur volumi i punës së punonjësve të Sektorit Informativ.

Gjatë kësaj periudhe, kemi pasur ndryshime rrënjësore në konceptim dhe vizualizim të produkteve tona. Po ashtu, kemi shtuar produktet informative, për të cilat edhe sondazhet e bëra nga organizatat e ndryshme tregojnë se kanë pasur shikueshmëri, e rrjedhimisht kanë rritur rejtingun e RTK-së në tregun medial në Kosovë, por edhe më gjerë.

6.4.1. DHOMA E LAJMEVE

6.4.1.1. LAJMET NË GJUHËN SHQIPE

Në kuadër të Sektorit Informativ të TVK-së, si sektor kryesor i mediumit publik, Dhoma e Lajmeve vazhdon të jetë shtylla kryesore e këtij sektori, sikurse ka qenë në vijimësi.

Që nga 24 tetori i vitit 2010, Dhoma e Lajmeve është pasuruar edhe me dy edicione informative: lajmet e orës 11:00 dhe lajmet e orës 13:00.

Me skemën e re programore, në gjuhën shqipe kemi gjashtë edicione informative: Lajmet e orës 11:00, 13:00, 15:00, 17:00, 19:30 dhe 23:00.

Lajmet e paradites (11:00, 13:00, 15:00, 17:00) kanë format kohor prej 10 minutash dhe kanë rezultuar të suksesshme dhe efektive, duke e bërë TVK (RTK) që të rrisë shpejtësinë e informacionit. Gjatë këtyre edicioneve kanë filluar të praktikohen në masë të shtuar edhe lidhjet e drejtpërdrejta nga terreni, të cilat më parë nuk kanë qenë veçori e këtyre edicioneve.

Lajmet e orës 19:30 vazhdojnë të kenë primatin në informimin e opinionit të Kosovës. Këtë e themi duke u mbështetur në sondazhet e bëra vazhdimisht nga organizata të ndryshme e që na pozicionojnë të parët sa i përket shikueshmërisë dhe besueshmërisë.

Edhe në lajmet e orës 19:30, të cilat kanë gjatësi prej 30 minutash, janë shpeshuar lidhjet e drejtpërdrejta nga terreni. Në edicionin e lajmeve të orës 19:30 janë plasuar kronika hulumtuese, të cilave u janë referuar mediat vendore dhe ato rajonale.

Lajmet e orës 23:00 kanë pësuar evolucion, duke integruar brenda tyre intervistën, e po ashtu duke angazhuar ekipe në terren për realizimin e kronikave, gjë që nuk ka qenë dukuri e këtij edicioni informativ më përpara.

Redaksia e lajmeve ndërkombëtare ka bashkëpunuar me sektorët e tjerë të Dhomës së Lajmeve, duke i furnizuar ata me informacione nga rajoni dhe bota. Në këtë sektor, gjatë fillimit të vitit 2011, do të fillojë edhe një emision javor me zhvillimet kryesore në botë.

6.4.1.2. REDAKSITË E LAJMEVE TË KOMUNITETEVE TË TJERA

Pas një periudhe të gjatë, pa një person përgjegjës në redaksitë e lajmeve dhe programin e komuniteteve, tashmë është një person përgjegjës, që në bashkëpunim me redaktorin përgjegjës të Programit Informativ është duke e monitoruar punën e tyre dhe është duke koordinuar punët për të rritur cilësinë programore. Format i kohor i edicioneve informative të komuniteteve joshqiptare është 10 minuta.

6.4.1.3. LAJMET NË GJUHËN SERBE, TERMINI 19:00

Punonjësit e këtij sektori tashmë marrin pjesë në mbledhjet e mëngjesit të Dhomës së Lajmeve e po ashtu kanë rritur bashkëpunimin me redaksinë e lajmeve të gjuhës shqipe, duke integruar brenda edicioneve të tyre informative kronika të prodhuara nga gazetarët e Dhomës së Lajmeve, e njëkohësisht duke evituar informacionet e mediave të tjera.

Redaksia në gjuhën serbe e RTK-Televizionit, duke u mbështetur në kontratat me disa televizione lokale në gjuhën serbe, të mbështetura nga një projekt i OSBE-së, merr dhe transmeton kronika të cilat pasqyrojnë aktualitetin dhe problematikat me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e pakicës serbe në vendbanime të ndryshme të Kosovës.

RTK-Televizioni ka vazhduar kontratat e bashkëpunimit me korrespondentët e vet në Beograd e Podgoricë, si dhe ka kontraktuar edhe korrespondent të rregullt nga Mitrovica.

Të gjithë këta korrespondentë raportojnë në baza ditore për ngjarjet që zhvillohen në vendet përkatëse.

Problematike mbetet zgjidhja e problemit të mbulimit me pamje të këtyre ngjarjeve.

Për të mbuluar këtë zbrazëti, RTK-Televizioni ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi me disa agjenci lajmesh, të cilat ofrojnë edhe zë e figurë nga shumë prej ngjarjeve që konsiderohen me interes për audiencën e edicioneve të lajmeve në gjuhën serbe në RTK-Televizion.

6.4.1.4. "NEDELNI KOLAZ"

Në programin javor të gjuhës serbe është integruar edhe reportazhi me probleme të përditshmërisë së jetës së qytetarëve serbë.

Një projekt i hartuar nga menaxhmenti i RTK-së, për zgjerimin e rubrikave në kuadër të këtij emisioni, është duke u zbatuar.

Gjatë vitit 2010, ka pasur përpjekje për rritjen e cilësisë së këtij emisioni, duke u përqendruar edhe në rritjen e sasisë së programit që prodhohet nga redaksia e këtij emisioni, por edhe në kujdesin për rritje të cilësisë së programit që prodhohet dhe transmetohet.

Projekti për zgjerimin e këtij emisioni do të vazhdojë dhe synohet të sigurohet sasi dhe cilësi më e madhe programi.

Po ashtu, gjatë vitit 2010, RTK-Televizioni, në kuadër të emisionit "Nedelni kolaz", ka përfshirë edhe rubrikën për sfidat e procesit të integrimit euroatlantik të Kosovës.

RTK-Televizioni, gjatë vitit 2010, në bashkëpunim me organizma të ndryshëm ndërkombëtarë, ka realizuar disa emisione të veçanta në gjuhën serbe.

Ato emisione kanë trajtuar probleme të ndryshme me të cilat ballafaqohet bashkësia etnike serbe në Kosovë.

Ndër ciklet më të rëndësishme të emisioneve të realizuara gjatë vitit 2010, veçohen ato të realizuara në kuadër të fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë.

Përfaqësuesve të të gjitha partive politike të serbëve të Kosovës, që kanë garuar në zgjedhjet e jashtëzakonshme të vitit 2010 në Kosovë, u është mundësuar që nga dy herë brenda periudhës së fushatës zgjedhore të shpalosin programin dhe ofertën e tyre për zgjedhësit serbë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2010, RTK-Televizioni ka realizuar edhe emisione në të cilat janë trajtuar problematika të veçanta, sikurse procesi i decentralizimit dhe i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

6.4.1.5. LAJMET NË GJUHËN BOSHNJAKE, TERMINI 18:45

Punonjësit e këtij sektori tashmë marrin pjesë në mbledhjet e mëngjesit të Dhomës së Lajmeve, e po ashtu kanë rritur bashkëpunimin me Redaksinë e lajmeve të gjuhës shqipe, duke integruar brenda edicioneve të tyre informative kronika të prodhuara nga gazetarët e Dhomës së Lajmeve, e njëkohësisht duke evituar informacionet e mediave të tjera.

6.4.1.6. "MOSTOVI"

Magazina boshnjake ka vazhduar të emetohet në vazhdimësi gjatë vitit 2010, duke u mundësuar shikuesve të interesuar që të njoftohen me problemet reale të banorëve boshnjakë. Nga Redaksia boshnjake kemi pasur vazhdimisht kërkesa për ndërrim të skenografisë.

6.4.1.7. LAJMET NË GJUHËN TURKE, TERMINI 18:30

Punonjësit e këtij sektori marrin pjesë në mbledhjet e mëngjesit të Dhomës së Lajmeve e po ashtu kanë rritur bashkëpunimin me redaksinë e lajmeve të gjuhës shqipe, duke integruar brenda edicioneve të tyre informative storie të prodhuara nga gazetarët e Dhomës së Lajmeve, e njëkohësisht duke evituar informacionet e mediave të tjera.

6.4.1.8. "MOZAIK"

Magazina turke ka vazhduar të emetohet në vazhdimësi gjatë vitit 2010, duke u mundësuar shikuesve të interesuar që të njoftohen me problemet reale të banorëve turq.

6.4.1.9. REDAKSIA ROME - EMISIONI "YEKHIPE"

Redaksia rome është e vetmja redaksi në RTK që nuk ka edicion të përditshëm informativ. Nga kjo redaksi vazhdimisht është përgatitur emisioni "Yekhipe", që trajton probleme të jetës dhe halleve të qytetarëve romë të Kosovës. Redaktori i kësaj redaksie ka shprehur gatishmërinë që të ketë edicion informativ të përditshëm, me kusht që të rritet numri i gazetarëve në redaksinë e tij. Gjatë vitit 2010 janë punësuar edhe dy gazetarë romë dhe pritjet që në pjesën e parë të vitit 2011 të fillojë edicioni i lajmeve edhe në këtë gjuhë.

6.4.1.10. LAJMI I FUNDIT

Është format informativ, që nuk është i planifikuar në skemën programore të TVK-së. Me këtë format vazhdimisht kemi pasur ndërhyrje, duke qenë të parët në tregun medial në Kosovë me plasimin e lajmeve të fundit nga terreni. Shumë herë gjatë ndërhyrjes me “Lajm të fundit”, shumë media janë lidhur me sinjalin e RTK-së.

6.4.2. PROGRAMI I MËNGJESIT

Emisioni i Mëngjesit vazhdon transmetimin e përditshëm të drejtpërdrejtë nga ora 07:00 deri në orën 09:30. Ndërkaq, të shtunën dhe të dielën ky emision fillon transmetimin në orën 08:00 dhe përfundon në orën 09:30. Ky program ka vazhduar me trendin e njëjtë që ka pasur gjatë viteve të kaluara. Në pjesën e parë të vitit 2011, Programi i Mëngjesit do të zgjerohet deri në orën 10:00, duke ndryshuar rrënjësisht në formë dhe përmbajtje, për t’iu përshtatur terminit dhe nevojave të audiencës.

6.4.3. REDAKSIA E AKTUALITETEVE

Gjatë vitit 2010, Televizioni i Kosovës, respektivisht Sektori Informativ, ka startuar me dy emisione të reja: “Dhjetë Minuta” dhe “Debat”. Aktualiteti ka rritur performancën e tij, qoftë duke u mbështetur në prodhimet e RTK-së, qoftë në bashkëprodhimet me produksionet e tjera. Megjithatë, në Sektorin e Aktualitetit mbetet sfidë më vete reformimi i disa emisioneve, të cilat nuk kanë arritur një nivel profesional të trajtimit të çështjeve me interes të publikut.

6.4.4. "DHJETË MINUTA"

Emisioni “Dhjetë Minuta” është format i ri i emisionit, në të cilin u është dhënë hapësirë të gjitha grupeve të interesit që t’i shpalosin idetë e tyre, e njëkohësisht duke u mundësuar atyre ballafaqimin me palën oponente. Para së gjithash, ky emision ka një rëndësi të veçantë për atë se si perceptohet RTK-ja nga audienca. Debatet me argumente dhe kundërargumente në RTK kanë ndikuar në përmirësimin e imazhit të Televizionit. Përpos këtij argumenti, ky emision ka mundësuar shtjellimin e mëturjeshëm të një teme që është trajtuar në edicionin e lajmeve të orës 19:30 – zakonisht temës kryesore të ditës.

6.4.5. "DEBAT"

Emisioni “Debat” ka krijuar identitetin e tij në skenën mediale në Kosovë. Çdo të premte, duke filluar nga ora 20:30, janë trajtuar çështje të aktualitetit politik. Përpos kësaj, me emisionin "Debat" kemi pasur ndërhyrje në skemën programore edhe gjatë ditëve të tjera të javës, kur kemi vlerësuar se është në interes të opinionit për të diskutuar rreth një çështjeje të caktuar. Kjo e ka bërë këtë emision koheziv dhe aktual për çështjet që janë diskutuar. Njëherësh, ky emision ka shërbyer edhe për

organizimin e debateve zgjedhore me përfaqësues të partive politike dhe analistë, qoftë para fushatës zgjedhore të 12 dhjetorit 2010, qoftë gjatë fushatës, por edhe gjatë rivotimeve në disa komuna të Kosovës. Për rritjen e performancës në këtë emision, në të ardhmen duhet të rritet numri i të angazhuarve, e po ashtu duhet të intensifikohen lidhjet e drejtpërdrejta nga jashtë studios.

6.4.6. "SUBVENCION"

Emisioni "Subvencion", që njëherësh është i vetmi emision në RTK që trajton ekskluzivisht tema nga ekonomia, është një emision që ka marrë vlerësime pozitive. Problemi që e ka shoqëruar këtë emision gjatë vitit 2010, me ndonjë përjashtim eventual, ka qenë se nuk ka filluar në terminin e përcaktuar nga skema programore e RTK-së. Për rritjen e performancës në këtë emision, në të ardhmen, duhet të rritet numri i të angazhuarve.

6.4.7. "EVROPA MË AFËR"

Ky emision është në përpjekje për krijimin e një identiteti të ri, duke u zhvendosur në skemën programore të RTK-së, duke u zgjatur si emision, por me një koncept më ndryshe. Gjatë vitit 2010, integrimi i magazinës në gjuhën serbe dhe i kuizit të diturisë ka rritur interesimin e audiencës.

6.4.8. EMISIONET E TJERA

"GRUAJA SOT", "PRO ET CONTRA", "BUJKU", "ZËRI YNË", "MEDIKA". Në përgjithësi, këto emisione kanë performancë jo të mirë. Gjatë vitit 2011, këto emisione duhet të reformohen rrënjësisht, për të plotësuar standardet profesionale të transmetimit në RTK.

Emisionet: "JETA NË KOSOVË", "DREJTËSIA NË KOSOVË", "TV DIASPORA"

"JETA NË KOSOVË"

Ky emision vazhdon të ketë interesimin e audiencës së RTK-së, marrë parasysh edhe hapësirën që i ka ofruar RTK-ja. Brenda tij janë shtjelluar tema të rëndësishme të shoqërisë sonë. Nevojitet një harmonizim më i mirë i përmbajtjeve që trajton ky emision dhe emisionet e tjera të RTK-së për të shmangur mundësinë e përsëritjeve.

"DREJTËSIA NË KOSOVË"

Është një emision i ri që ka filluar të emetohet në TVK (RTK). Fillimisht ishte konceptuar si emision i terrenit, duke paraqitur para audiencës aksionet në terren të Policisë së Kosovës. Ky emision do të ishte mirë që ta vazhdonte këtë koncept të realizimit, duke evituar debatet në studio.

"TV DIASPORA"

Emisioni "TV Diaspora", që prezanton dhe trajton probleme të diasporës kosovare në vendet e Perëndimit, me gjithë rekomandimet e vazhdueshme, nuk ka arritur t'i shmanget prezantimit të aktiviteteve të të mërguarve në vendet e Perëndimit në formë klasike dhe joatraktive.

6.4.9. PROJEKTET E TJERA TË TVK-së GJATË VITIT 2010

ZGJEDHJET 2010

Projekti më i rëndësishëm i vitit 2010 nga Sektori i Aktualitetit ka qenë mbulimi i fushatës zgjedhore të vitit 2010.

Gjatë dhjetë ditëve fushatë, nga 01.12.2010 deri më 10.12.2010, RTK ka mbuluar mbi 90% të aktiviteteve të partive politike me një korrektësi dhe paanshmëri të lakmueshme për çdo medium. Këtë e mbështet edhe vlerësimi i KPM-së (Komisioni i Pavarur për Media), i cili e rendit RTK-në të parën sa i përket mbulimit të fushatës zgjedhore, duke treguar objektivitet dhe ekuilibër në plasimin e informacioneve nga fushata zgjedhore.

Përpos mbulimit të fushatës dhe prezantimit të saj në edicionin informativ të orës 19:30, TVK - Sektori i Informacionit, gjatë fushatës zgjedhore, çdo natë u ka dedikuar një edicion special aktiviteteve të partive politike. Shtatë subjektet politike shqiptare janë prezantuar me rotacion në 'roundup'-in zgjedhor të lajmeve të orës 19:30, e po ashtu edhe në edicionin e përnatshëm dedikuar fushatës zgjedhore.

Edhe fushata e subjekteve politike joshqiptare është prezantuar në edicionet informative të komuniteteve joshqiptare në RTK.

Përpos prezantimit të fushatës, TVK - Sektori i Informacionit ka pasur çdo natë "Debatën zgjedhor", ku u është dhënë mundësia përfaqësuesve të partive politike në garë për zgjedhjet e 12 dhjetorit që të shpalosin platformën e tyre programore. Po ashtu, është realizuar intervistë me secilin lider të subjekteve politike shqiptare, në garë për zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010. Ndihmesë të madhe në këtë drejtim ka dhënë edhe emisioni "Jeta në Kosovë", që u mundësoi secilit përfaqësues të subjektit politik që të shpalosë ofertën e tij programore për një resor të caktuar të qeverisjes së ardhshme të vendit.

Në TVK, në terminë kohorë të pasdites kemi pasur edhe debate ku të gjitha komunitetet e tjera, respektivisht përfaqësuesit e partive të tyre, kanë shpalosur

ofertën programore. Për dallim prej partive boshnjake, turke, rome, ashkalinje dhe egjiptase, partitë politike serbe, malazeze dhe të goranëve kanë qenë të pranishme në ekranin e RTK-së çdo ditë të fushatës zgjedhore, përmes emisionit të përgatitur nga një produksion i jashtëm, por që i ka shërbyer RTK-së për të mbuluar dhe për t'u dhënë hapësirë përfaqësuesve të komuniteteve të sipërpërmendura.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, më 12 dhjetor, kemi qenë televizioni që ka mbuluar në mënyrën më efektive të gjitha aktivitetet zgjedhore.

6.4.10. NGJARJE TË TJERA TË JASHTËZAKONSHME

Gjatë vitit 2010, RTK-Televizioni ka realizuar edhe projekte të tjera tepër të rëndësishme për ngjarje të jashtëzakonshme, ndër të cilat veçojmë programin gjithëditor në ditën e seancës për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, si dhe vizita të personaliteteve të ndryshme botërore në vendin tonë. Për t'u veçuar në këtë kontekst është vizita e Sekretares Amerikane të Shtetit, Hillary Clinton. RTK, përveç mbulimit profesional të tërë agjendës së saj në Kosovë, ka qenë televizioni i parë evropian, të cilit Departamenti Amerikan i Shtetit ia ka besuar organizimin e një debati me publik të numrit një të politikës së jashtme amerikane.

6.4.11. REKAPITULLIM I TË ARRITURAVE DHE NGECJEVE TË SEKTORIT INFORMATIV NË TVK - RTK

Televizioni i Kosovës (RTK), respektivisht Programi Informativ, gjatë vitit 2010, ka bërë lëvizje pozitive të lakmueshme drejt rritjes së performancës dhe cilësisë. Plasimi i disa emisioneve të reja, rifreskimi i skenografive, e po ashtu ndryshimi i siglave është absorbuar nga audienca si ndryshim pozitiv në RTK. Shtimi i numrit të edicioneve informative po ashtu ka ndikuar që Sektori i Informacionit në RTK të plasojë lajme në kohë reale. "Lajmi i fundit" i ka mundësuar RTK-së që të thyejë shabllonet kohore të parapara për transmetim të Programit Informativ, duke na mundësuar kështu që në çdo çast kur vlerësohet se duhet të ketë ndërhyrje në skemë programore, kjo të jetë e mundur, për të qenë të parët nga mediat në plasimin e informacionit. Megjithatë, TVK-së, edhe pse ka debate në studio, të cilat kanë pasur ngritje të vazhdueshme të performancës së tyre, i mungojnë emisionet nga terreni, kronika të zgjeruara nga terreni, ku gazetarët do të kishin hapësirë më të madhe për të shtjelluar probleme të ndryshme.

Për Sektorin e Informacionit ka qenë e dobishme pranimi i gazetarëve-praktikantë, të cilët nga dita në ditë janë duke e ngritur performancën e tyre. Megjithatë, në Sektorin e Informacionit ka edhe shumë defekte dhe çalime, të cilat janë kryesisht rezultat i papërgjegjësisë së të punësuarve. Mangësi tjetër në Sektorin e Informacionit vazhdon të jetë fakti se disa pozita menaxheriale editoriale vazhdojnë të jenë vakante.

Problem tjetër, nga i cili varet puna e Sektorit të Informacionit, është rritja e bashkëpunimit ndërsektorial. Bashkëpunimi ndërmjet Sektorit të Informacionit dhe sektorëve të tjerë të TVK-së nuk është i nivelit të kënaqshëm.

6.5. PROGRAMI KULTUROR, ARSIMOR, DOKUMENTAR DHE PËR FËMIJË (PKADF)

6.5.1. Programi Arsimor

Programi Arsimor po mbahet me emisione të huajtura, që të gjitha repriza, sepse studioja e sinkronizimeve është jashtë funksionit. Janë transmetuar gjithsej 260 emisione të huajtura dokumentare-arsimore dhe janë realizuar e transmetuar 48 emisione origjinale arsimore “Këshilla juridike” dhe vetëm katër emisione arsimore “Edukimi qytetar”, katër emisione “Mjekësia”, kurse janë realizuar dy emisione “Informatika aplikative”, por nuk janë transmetuar, sepse kanë munguar kushtet operative-teknike për vazhdimin e realizimit të tyre.

6.5.2. Programi për Fëmijë

Në Programin për Fëmijë janë transmetuar gjithsej 356 emisione origjinale, pa i llogaritur këtu emisionet për fëmijë që janë realizuar jashtë PKADF-së. Edhe gjatë kësaj periudhe ka pasur shumë repriza të paplanifikuara, veçanërisht tek emisioni UNË E DI, PO TI, por edhe emisionet e tjera. Në gjysmën e dytë të vitit 2010 ka pasur edhe repriza të emisionit “Shkolla ime”.

Sidoqoftë, janë realizuar e transmetuar emisione për fëmijë, si: “Nënat dhe mësueset për parashkollorët”, “Festa e Abetares”, “Përvjetori i Pavarësisë”, “Semimatura”, “Agim Deva”, “Faik Konica”, “Mitrush Kuteli” dhe në veçanti edicionet e kuizit “1,2,3, FILLO”. Krahas ndryshimeve të vogla në skenografinë e këtij emisioni, sivjet ishte risi edhe vetë karakteri i emisionit dhe struktura e tij, sepse kuizi pati karakter të garimit individual.

6.5.3. Programi i Kulturës

Në Programin e Kulturës janë realizuar dhe transmetuar mbi 130 emisione KULT, PRO ARTE, ARTE PAMORE, natyrisht, të gjitha premiera. Nga kjo redaksi janë realizuar edhe shumë xhirime e transmetime të drejtpërdrejta programore nga ngjarje, manifestime, përvjetorë e akademi solemne, janë mbuluar ngjarje e rrjedha të rëndësishme kulturore, shkencore e artistike, janë promovuar e prezantuar libra, dokumentarë, filma, shfaqje teatrore e koncerte e festivale të muzikës, janë prezantuar krijues e artistë etj.

6.5.4. Programi Dokumentar

Kanë qenë më të paktë dokumentarët e realizuar nga stafi i brendshëm i PKADF-së dhe shumë më i madh numri i dokumentarëve të realizuar nga autorë të jashtëm, si dhe dokumentarë të prodhuesve të jashtëm vendorë e ndërkombëtarë.

Ndër prodhimet e RTK-së duhen veçuar dokumentarët si “Kodi i Jetës”, “Magji me këmbë” - dy pjesë, “Shqiptarët e Rumanisë” - tetë pjesë etj., pastaj dokumentarët si “Një mendje e ndritur”, “Andërra e jetës”, Kanarinat e Çabratit” etj. – prodhime vendore dhe shumë dokumentarë të huajtur të titruar, si dhe shumë emisione dokumentare kushtuar dëshmorëve dhe përvjetorëve të rëndësishëm të Luftës së UÇK-së.

Kaptinë e veçantë e këtij programi është këmbimi në kuadër të EBU-së dhe seksionit të saj ERNO, pra me RTV-të publike të Evropës Juglindore. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, ndryshe nga viti i kaluar kur kishim dhënë një e kishim marrë 10 dokumentarë, sivjet, nga oferta jonë prej tre dokumentarësh, RTV-të e vendeve anëtare të EBU-së i kanë përzgjedhur dokumentarët tanë “Kodi i jetës” dhe “Bektashizmi”.

Po ashtu, sivjet, me ndërmjetësim të Seksionit ERNO të EBU-së, në këmbim RTK-ja ka marrë dokumentarët e prodhimit italian për teatrin "Skampa" të Napolit, për Kështjellat e Napolit, për teatrin "La Scala" të Milanos dhe dokumentar për Venecinë.

6.5.5. Programi i Dramës

Prej vitesh, Programi i Dramës nuk ishte aktiv. Në gjysmën e parë të vitit 2010 është shënuar një përpjekje për riaktivizimin e këtij programi, pikërisht me shfaqjen televizive “Kurrë më”. Është ritransmetuar edhe shfaqja teatrale “Ku është populli”, realizim i TK-së.

6.6. PROGRAMI ARGËTUES, MUZIKOR DHE SPORTIV (PAMS)

6.6.1. REDAKSIA E MUZIKËS

Redaksia e Muzikës ka përmbushur me sukses objektivat e veta. Ka ideuar, realizuar dhe transmetuar me sukses emisione, koncerte dhe festivale, të cilat janë sjellë profesionalisht para publikut të RTK-së. Ka marrë iniciativën e shkëlqyeshme për dekorimin e znj. Nexhmije Pagarusha me medaljen “Artist i Merituar”, nga ana e presidentit të Republikës së Kosovës. Ka ideuar dhe realizuar me sukses gala-koncertin për znj. Nexhmije Pagarusha, i cili është vlerësuar lart nga audienca, projektin “E dua muzikën” (7 mbrëmje muzikore), nga këngët e vallet arbëreshe e deri tek ato kosovare, gala-koncertin për artistin Muharrem Qena, projektin e programit festiv për Vitin e Ri, për të cilin janë realizuar 326 këngë (për fëmijë, argëtuese, popullore folklorike dhe klasike). Kjo redaksi ka përpiluar të gjitha përmbajtjet muzikore që janë transmetuar drejtpërdrejt në RTK. Ka mbledhur materiale muzikore në formë të videoklipeve, të cilat i ka selektuar për transmetim, gjithmonë duke iu përmbajtur kriterëve profesionale të RTK-së.

- 01.02.2010 Koncert Recital - Hysni Klinaku
- 03.02. - Filharmonia e Kosovës – Pallati i Rinisë
- 08.02. - Koncerti i Pavarësisë – Studio RTK
- 17.02. - Filharmonia e Kosovës – Koncert Festiv - drejtpërdrejt
- 25.02. - Muzikë Klasike – Kisha Katolike
- 28.02. - Filharmonia e Kosovës – Pallati i Rinisë
- 05.03. - Epopeja e UÇK-së - Transmetim i drejtpërdrejtë nga “Nëna Terezë”
- 06.03. - Transmetim i drejtpërdrejtë nga Prekazi
- 07.03. - Nata e Zjarreve - transmetim i drejtpërdrejtë
- 15.03. deri më 25.04. - Shopin Fest, xhirime të 14 koncerteve
- 13.03. - Koncert Sihana Badivuku – Muzeu Kombëtar
- 27.03. - Koncert Tusha-Xeni, drejtpërdrejt nga Gjakova
- 04.04. - Dekorimi i znj. Nexhmije Pagarusha
- 09.04. - Dita e Evropës, transmetim i drejtpërdrejtë
- 18.05. deri më 25.05, Re Musica – xhirime të 9 koncerteve
- 23.05. - Gala-koncerti për Nexhmije Pagarushën –
Transmetim i drejtpërdrejtë nga Teatri Kombëtar
- 25.05.- Eurovizioni 2010 – Komentim
- 29.05.- Eurovizioni 2010 – Finalja / Komentim
- 03.06.- Koncert jubilar i Akademisë së muzikës
- 04.06.- Koncert me konkurruesit e rinj
- 06.06.- Festivali folklorik “I këndojmë lirisë” - Klinë, xhirim
- 16.06.- Emision folklorik “Ansambli Azem Bejta”, xhirim
- 17.06.- Big-bendi në përvjetorin e ditëlindjes së Mbretëreshës britanike
- 22.06.- Koncert-homazh për Bekim Fehmiun - drejtpërdrejt nga Pallati i Rinisë
- 02.07.- 11.07- Gjashtë emisione verore
- 14.07.- 22.07- Shtate emisione verore (“E dua muzikën”)
- 06.09.- 10.07- Kllapa e Ulqinit dhe Ansambli Shota, në Kalanë e Balshajve në Ulqin
- 10.09.- Dy emisione me krijimtarinë popullore të Malësisë së Madhe në Tuz
- 16.10.- Gala-koncert për artistin Muharrem Qena

- 01.11.- Mbledhja e materialit muzikor për Festën e Vitit të Ri, orkestrimet, ushtrimet e Bendit të RTK-së dhe realizimi i 326 këngëve.
- 14.12.- 27.12.- Xhirim i programit festiv. Emisioni argëtues "Shi n'kallamoq" dhe disa emisione të tjera nëpër rrethe.

6.6.2. REDAKSIA E ARGËTIMIT

Gjatë sezonit 01.01- 30.06.2010, janë realizuar 42 emisione të drejtpërdrejta nga 2 orë, çdo të shtunë dhe të diel, "RTK BLUE". Ky emision ka pasur pretendime që të jetë edhe më i realizuar profesionalisht, por mungesa e hapësirës, mungesa e buxhetit, skenografisë dhe ndriçimit ka qenë hendikep për realizimin e duhur.

Emisioni argëtues "OXYGEN" - ka vazhduar me trendin e vet të pandryshuar, por të pëlqyeshëm nga ana e audiencës. Është transmetuar çdo të premte në orën 21:30 dhe me ndryshimet e terminit sipas nevojave të skemës programore të RTK-së. Autori i emisionit duhet ta koordinojë punën me redaktorin përgjegjës.

Emisioni "Pa Skenar" - ka vazhduar të transmetohet çdo të hënë në orën 23:15 dhe ka sjellë nostalgji nga e kaluara artistike e njerëzve të artit dhe të kulturës.

Emisioni "Pa rrotlla" - është transmetuar çdo të shtunë në orën 23:15. Sipas përmbajtjes, ky emision duhet të sistemohet në ndonjë redaksi tjetër.

Emisioni "Kush do të bëhet milioner" - ka vazhduar të transmetohet çdo të hënë në orën 21:00 dhe është ritransmetuar gjithmonë të dielën.

6.6.3. REDAKSIA E TË RINJVE

Redaksia e të rinjve ka ideuar dhe ka realizuar me sukses emisionin me emrin e ri "Rin'on". Për këtë emision është realizuar skenografia e re dhe përmbajtja e tërësishme. Që në editimet e para është treguar i suksesshëm në tërësi. Vlen të theksohet se kjo redaksi gjatë qershorit ka realizuar edhe tri emisione me të rinjtë në Shqipëri. Ky emision është transmetuar çdo të shtunë, në orën 18:30.

6.6.4. REDAKSIA PËR FILMA TË HUAJ DHE SERIALE

Seriali vendor "Familja Moderne" - ka vazhduar të transmetohet çdo të diel në orën 20:15. Shikueshmëria e këtij seriali, sipas sondazheve, mbetet e nivelit të lartë, pavarësisht vërejtjeve edhe publike për përmbajtjen e tij. Është ndërhyrë me reduktimin e shpenzimeve për realizimin e tij dhe po ngulet këmbë që të arrihen përmirësime përmbajtjesore, në mënyrë që të kryejë obligimin që ka ndaj audiencës. Seriali tjetër "Kafeneja jonë" - ka vazhduar të transmetohet çdo të hënë në orën 20:30. Vazhdon të jetë i shikuar.

Emisioni "Telekino" - ka vazhduar të transmetohet në terminin e tij të përhershëm, çdo të shtunë në orën 18:00. Vlen të theksohet udhëtimi i ekipit në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Berlinit dhe Festivalin e Filmit në Kanë. Nga

këto dy festivale, ekipi ka realizuar 6 emisione. Gjithashtu, edhe udhëtimi për në Los Anxhelos “Hollywood” ka qenë i suksesshëm, duke na sjellë dy emisione mjaft të vlefshme për Telekinon e RTK-së.

Filmat e huaj artistikë dhe serialet humoristike – Është arritur marrëveshja me “Kosova Filmin” për filmat artistikë dhe dokumentarë që në periudhën 3-vjeçare të transmetohen vetëm në RTK. Janë blerë 136 filma artistikë të huaj dhe 10 emisione cirku për nevojat e redaksisë së filmit. Kostoja për këta filma është dukshëm më e ulët se më parë.

6.6.5. REDAKSIA E SPORTIT

Redaksia e sportit ka evidentuar, ka xhiruar dhe ka transmetuar pothuajse të gjitha ngjarjet e rëndësishme të sportit vendor dhe atij ndërkombëtar.

Emisioni “Sport plus” - vazhdon ta mbledhë kërkuesin e shikuesve, ashtu sikurse edhe emisioni AS. Redaksia e sportit me sukses ka përgatitur emisione debatuese për sportin. Vlen të theksohen emisionet e përgatitura gjatë kampionatit botëror “Afrika e Jugut 2010”. Ka funksionuar padyshim ideja e vetëm dy analistëve në studio, por nuk ka funksionuar në mënyrën më të mirë loja shpërblyese, të cilën paraprakisht e kemi diskutuar në kolegji.

Kjo redaksi, në të ardhmen duhet të menaxhohet me më shumë profesionalizëm dhe të shmanget mundësia e mbetjes së RTK-së pa ngjarje të rëndësishme sportive, siç ishte rasti me Kampionatin Anglez të Futbollit.

Redaksia e sportit, me gjithë vështirësitë në sigurim, po e mbulon Ligën e Kampionëve.

6.7. SHËRBIMI PROGRAMOR I TELEVISIONIT TË KOSOVËS

6.7.1. Hyrje

Ky raport vjetor i punës pasqyron në formë tekstuale, tabelare dhe grafike të gjitha aktivitetet e Shërbimit Programor gjatë vitit 2010, si dhe adreson problemet, vështirësitë dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ky shërbim gjatë vitit raportues. Dokumenti është i ndarë në kapituj të veçantë për secilën njësi punuese të Shërbimit Programor. Secili kapitull përbëhet nga pjesa narrative e aktivitetëve të kryera në njësinë përkatëse gjatë gjithë vitit raportues dhe pjesa tabelare, ku pasqyrohen problemet dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar njësia dhe propozimet për plane zhvillimore për periudhat e ardhshme.

Raporti vjetor i punës përmbyllet me një përmbledhje të konkluzioneve, vërejtjeve dhe rekomandimeve për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Shërbimit Programor.

6.7.2. Departamenti i Programeve të Huaja

Departamenti i Programeve të Huaja i Shërbimit Programor ka vazhduar që edhe gjatë vitit 2010 të zhvillojë kontaktet me kompanitë e jashtme distribuese dhe kanalet e huaja televizive për sigurimin dhe blerjen e programeve, serialeve dhe filmave të ndryshëm për nevojat e Televizionit, që paraqet aktivitetin themelor të këtij departamenti. Në këtë drejtim është zhvilluar një bashkëpunim i kënaqshëm me njësitë e tjera të Televizionit. Është mbajtur një evidencë sistematike e gjithë materialit të siguruar dhe të transmetuar. Në tabelat e paraqitura më poshtë janë të pasqyruara në formë më të detajuar të gjitha aktivitetet e Departamentit të Programeve të Huaja.

Titulli	Për nevoja të redaksisë	Muaji
Koncerti i Vitit të Ri i Filarmonisë së Vjenës	PAMS	Janar
Koncerti i Filarmonisë së Vjenës në Lubjanë (Kleiber)	PAMS	Tetor
Koncerti i Filarmonisë së Vjenës – Shonbrun 2010	PAMS	Mars
“Golden Globe Awards 2010”	PAMS	Janar
“Grammy Awards 2009”	PAMS	Shkurt
Gjysmëfinalja dhe finalja e Këngës së Eurovizionit	PAMS	Maj
“Brit Awards 2010”	PAMS	Shtator
Kontrata për çmimet televizive “Emmy 2010”	PAMS	Shtator
Dokumentari muzikor “MTV Staying Alive”	PAMS	Dhjetor

Transmetimet e drejtpërdrejta të evenimenteve artistike ndërkombëtare, të siguruara nga Departamenti i Programeve të Huaja i Shërbimit Programor

Janë negociuar dhe janë siguruar edhe disa programe dokumentare nga kanali francez “Arte”, pastaj programet e shkurtra franceze dyminutëshe për Programin e Mëngjesit “Portret”, dhe priten 4 filma të vizatuar dyminutësh nga dy kompani franceze "Terra Noa" dhe AWOL. Po ashtu, është në proces negocimi dhe pagesa e dy serialeve të filmave të vizatuar me kohëzgjatje prej 26 minutave, të titulluar “Little Prince” dhe “I.N.K.” nga kompania franceze PGS. Vlen të ceket se 90% të programeve franceze i financon CFI-ja franceze, e cila ndihmon edhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të RTK-së në marketet televizive ndërkombëtare. Kësisoj, koordinatori e Programeve të Huaja dhe koordinatori në program kanë marrë pjesë në marketin televiziv "Discop East 2010" që është mbajtur në Budapest në muajin qershor. Pos këtij marketi, koordinatori ka marrë pjesë edhe në një market tjetër televiziv në Biarritz të Francës në muajin shtator. Edhe kjo pjesëmarrje e RTK-së në këto markete është përkrahur nga kanali ndërkombëtar francez CFI.

Shumë nga materialet e lartpërmendura janë pranuar dhe janë në procesin e përgatitjes për transmetim, kurse disa sosh tashmë janë të gatshme për t'u transmetuar.

Serial/Film artistik	Titulli	Për nevoja të redaksisë
Serial	Life unexpected (nga Studio Moderna)	PAMS
Serial	Jake 2.0 (nga Studio Moderna)	PAMS
Serial	Flash Gordon (nga Studio Moderna)	PAMS
Serial	Robinson Kruzo (nga Studio Moderna)	PAMS
Serial	Blind Justice (nga Studio Moderna)	PAMS
Dokumentar për fëmijë dhe të rritur	EBU Solpack Gratis nga EBU-ja	PAMS PKADF
Dokumentar	4 dokumentarë nga Kosovafilmi	PKADF
Dokumentar	3 dokumentarë lidhur me këngën e Eurovizionit. (Çnumërimi para Eurovizionit)	PAMS
Film artistik	74 filma nga kompania Smart Solutions (Shqipëri)	PAMS
Film artistik	12 filma nga Studio Moderna	PAMS
Film artistik	11 filma nga Kosovafilmi	PAMS
Film artistik	35 filma nga Promedia	PAMS
Programe të tjera	10 shfaqje cirku nga kompania Smart Solutions (Shqipëri)	PAMS
Programe të tjera	The Best of the European Opera 2010 (Do të transmetohet në shkurt 2011)	PAMS

Filmat artistikë dhe programet e tjera të siguruara nga Departamenti i Programeve të Huaja i Shërbimit Programor

Për filmat artistikë të cekur në tabelën 2 është bërë pranimi i materialit, është mbikëqyrur procesi i bartjes nga DVD në SX dhe janë siguruar dialog-listat në rastet kur ato kanë munguar.

Gjatë këtij viti është bërë dorëzimi i rregullt në transmetim në baza javore dhe është mbajtur evidenca e episodeve të transmetuara të serialeve, të cilat janë kontraktuar në periudhat e mëhershme raportuese.

6.7.3. Njësia e post-produksionit

Aktivitetet e Njesisë së post-produksionit përfshijnë sigurimin e shërbimeve të përkthimit dhe lekturimit të materialeve, si në vijim:

- Dokumentarëve
- Filmave artistikë
- Serialeve
- Emisioneve të tjera sipas nevojës

Si pjesë e aktiviteteve të kësaj njësie është edhe mbajtja e korrespondencës së rregullt me kontraktuesit e shërbimeve të lartpërmendura, si dhe përgatitja e raporteve dhe procedimi i pagesave të tyre.

Sa u përket vështirësive me të cilat është përballur kjo njësi punuese, vlen të përmenden vonesat e pagesave për përkthyesit dhe lektorët nga shërbimi i financave.

6.7.4. Njësia e titrimin

Veprimtaria kryesore e kësaj njësie të Shërbimit Programor është titrimi i të gjitha emisioneve, filmave, dokumentarëve e serialeve të huaja në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve. Funksionimi i kësaj njësie është i lidhur ngushtë me Njësinë e post-produksionit dhe Departamentin e Programeve të Huaja.

Vlen të ceket se nga kjo njësi pune është larguar një operator i titrimin, i cili pas mbarimit të studimeve universitare, është transferuar në Njësinë e këmbimit EVN. Pas këtij transferimi, numri i të punësuarve në Njësinë e titrimin nga 3 ka rënë në vetëm 2 të punësuar.

Koeficienti aktual i operatorëve në titrim është 1.99. Pas pakënaqësisë së punëtorëve të kësaj njësie, në fillim të vitit 2007, është vendosur që kjo pakënaqësi të zgjidhet përmes ofrimit të një aneks-kontrate në vlerë prej 0.25 koeficientesh. Është kërkesë e vazhdueshme e këtyre punëtorëve që të gjendet një zgjidhje afatgjatë për çështjen e koeficientit të tyre.

Punëtorët e kësaj njësie po ashtu kanë ankesa edhe për shkak të mosavancimit të tyre horizontal apo vertikal, me gjithë përvojën shumëvjeçare të punës në RTK. Kjo ankesë e punonjësve të kësaj njësie është akoma aktuale, sidomos pas zvogëlimit të numrit të punëtorëve në këtë njësi. Edhe për këtë problem në këtë njësi është bërë një zgjidhje e përkohshme, sikur në Njësinë e MCR-së dhe atë të skemës programore, pra të punësuarit janë shpërblyer me nga një aneks-kontratë.

6.7.5. Njësia e këmbimit - EVN

Njësia e këmbimit - EVN i ka zhvilluar aktivitetet e veta lidhur me pranimin dhe dërgimin e materialeve nga bota, në koordinim me rrjetin e EVN-së. Kështu, gjatë vitit 2010 janë dërguar:

- 169 materiale (kronika) nga Kosova për nevojat e EVN-së dhe ERNO-s, duke shkruar tekstet dhe duke montuar pamjet për këmbim,
- 21 transmetime të drejtpërdrejta nga Kosova

Përpos dërgimit të materialeve të montuara dhe atyre të drejtpërdrejta nga Kosova, Njësia e këmbimit - EVN po ashtu për nevojat e Dhomës së Lajmeve ka pranuar shumë materiale lidhur me reagimet nga bota rreth zhvillimeve në Kosovë dhe rreth saj. Njësia e këmbimit ka bashkëpunuar ngushtë dhe ka koordinuar punët me gazetarë, redaktorë dhe producentë, me qëllim të identifikimit të materialeve të nevojshme programore.

- Është informuar Redaksia e lajmeve për kronikat dhe transmetimet LIVE nga ngjarje të ndryshme.

- Është informuar vazhdimisht Redaksia e lajmeve dhe redaksitë e tjera që marrin materiale në këmbim, për kronikat që kanë të bëjnë me Kosovën dhe ngjarje të tjera me interes për ta.
- Është kontaktuar EBU për çështje të ndryshme teknike.

Pos dërgimit të materialeve, Njësia e këmbimit po ashtu ka pranuar për nevojat e Dhomës së Lajmeve shumë materiale lidhur me reagimet nga bota rreth zhvillimeve në Kosovë dhe rreth saj. Falë bashkëpunimit tonë të shkëlqyeshëm me EVN-në dhe EBS-në, është arritur që të sigurohen materiale LIVE ekskluzivisht vetëm për RTK-në (p.sh. gjatë Samitit të Dubrovnikut, që është mbajtur nga 9 deri më 11 qershor).

Muaji	Numri i kronikave dhe transmetimeve LIVE të dërguara
Janar	13 kronika të lajmeve dhe një transmetim LIVE nga vizita e presidentit të Kroacisë, Mesiç, në Kosovë
Shkurt	12 kronika të lajmeve dhe 3 transmetime LIVE nga festimi i përvjetorit të pavarësisë dhe vizita e Kethrin Ashtonit në Kosovë
Mars	12 kronika të lajmeve dhe një transmetim LIVE nga vizita e ministrit francez të Punëve të Jashtme, Bernard Kushner, në Kosovë
Prill	13 kronika të lajmeve
Maj	12 kronika të lajmeve dhe një transmetim LIVE nga vizita në Kosovë e komisionarit Stefan Fule
Qershor	14 kronika të lajmeve dhe 3 transmetime LIVE nga Samiti i Prevallës dhe nga vizita në Kosovë e sekretarit britanik për çështje evropiane, Dejvid Lidington
Korrik	7 kronika dhe një transmetim LIVE nga vizita e ish-kryeministrit britanik, Blair, në Kosovë
Gusht	15 kronika
Shtator	18 kronika
Tetor	16 kronika dhe 2 transmetime LIVE nga vizita e sekretares amerikane të Shtetit, Hillary Clinton
Nëntor	14 kronika dhe 2 transmetime LIVE nga votimi në Kuvend për shkarkimin e qeverisë Thaçi dhe vizita e kryeministrit turk, Erdogan, në Kosovë
Dhjetor	23 kronika dhe 2 kronika të zgjeruara nga 15 minuta për fushatën paraelektorale për zgjedhjet parlamentare, si dhe 5 transmetime LIVE lidhur me zgjedhjet parlamentare dhe shpalljen e rezultateve preliminare
Gjithsej:	169 kronika të lajmeve dhe 21 transmetime të drejtpërdrejta

Materialet e dërguara nga Njësia e këmbimit EVN gjatë vitit 2010

6.7.6. Njësia e regjisë së ditës - MCR

Në Njësinë e regjisë ditore - MCR - është bërë implementimi i skemës programore të RTK-së. Një kryerje të suksesshme të këtij aktiviteti bazë e ka mundësuar bashkëpunimi i ngushtë me njësitë e tjera të televizionit, veçanërisht me atë të skemës programore dhe të arkivit. Gjatë vitit raportues, në këtë njësi është bërë ndërrimi i udhëheqësit, me ç'rast udhëheqësi i mëparshëm i kësaj njësie është transferuar në një vend tjetër pune në RTK, derisa udhëheqësi i ri ka arritur që me sukses të realizojë përgjegjësitë dhe obligimet e tij si udhëheqës i Njësisë së regjisë ditore MCR.

6.7.7. Arkivi

Arkivi, si njësi shumë e rëndësishme e Shërbimit Programor edhe e Televizionit të Kosovës në përgjithësi ka sistemuar të gjitha emisionet e transmetuara të RTK-së, duke evidentuar të dhënat kryesore të tyre në bazën elektronike të të dhënave të arkivit dhe ka asistuar në baza të rregullta ditore gazetarët, redaktorët, producentët dhe organizatorët e Televizionit në gjetjen e materialeve të ndryshme arkivore për nevoja programore. Pos kësaj, Arkivi ka bërë edhe gjetjen dhe identifikimin e materialeve të ndryshme arkivore, në bazë të kërkesave nga personat fizikë dhe juridikë jashtë RTK-së, kërkesa e të cilëve për materiale arkivore të RTK-së është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së apo nga Drejtori i Televizionit. Arkivi ka shërbyer edhe si pikë e fundit e furnizimit me kasete të reja për gjithë televizionin.

6.7.8. Njësia e skemës programore

Sa u përket aktiviteteve të kësaj njësie të Shërbimit Programor mund të thuhet se ajo në tërësi i ka kryer aktivitetet e saj, si në vijim:

- Përgatitja e skemës programore ditore, javore dhe mujore në rrjetin tokësor dhe satelitor;
- Vendosja ditore dhe javore e skemës programore në rrjetin e brendshëm për kajrone;
- Përgatitja e skemës programore (word) për nevojat e shtypit ditor
- Bashkëpunimi me producentë dhe redaktorë të programeve e emisioneve për hartimin e skemës programore;
- Koordinimi në baza ditore me dhomën e transmetimit/MCR dhe implementimi i ndryshimeve në skemë;
- Mbulimet adekuate në rastet e ndryshimeve të skemës programore.

6.7.9. Njësia e promociionit

Ka vazhduar punën njësia më e re e Shërbimit Programor, ajo e promociionit. Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga kjo njësi, vlen të veçohen:

- Promovimi i detajuar i programit javor në ueb-faqen e RTK-së, me saktësisht në faqen e parë dhe rubrikën e re TV TIP. Në këtë kuadër janë përgatitur tekstet dhe pamjet për promovimin e qindra emisioneve premierë në rubrikën e lartpërmendur.

Koordinimi dhe planifikimi për emetim të spoteve reklamuese me karakter jokomercial që transmetohen në Televizionin e Kosovës për organizatat dhe institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Gjatë vitit 2010 janë transmetuar më se 100 sosh.

- Koordinimi i prezantimit të përshkrimeve të emisioneve televizive në ueb-faqen e Radiotelevizionit të Kosovës.
- Procedimi i kërkesave për shfrytëzim të materialeve të ndryshme arkivore, të pranuar nga persona privatë apo zyrtarë.
- Përpilimi i njoftimeve zyrtare për konsumatorë, organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare, duke përfshirë audio-përgatitjen, koordinimin e materialit me njësinë e grafikës për përgatitjen e dizajnit grafik, si dhe planifikimin për emetim në koordinim me skemën programore.
- Koordinimi dhe planifikimi për emetim të kampanjës informuese dhe motivuese nga KQZ-ja lidhur me Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë.

6.7.10. Njësia e statistikës dhe e hulumtimit programor

Edhe pse e një rëndësie të veçantë, Njësia e paraparë e statistikës dhe e hulumtimit programor nuk ka arritur që të aktivizohet as gjatë vitit 2010. Aktivizimi sa më i hershëm i kësaj njësie është shumë i domosdoshëm, për shkak se edhe vetë ky raport pune do të ishte më i pasur me informata dhe statistika më të detajuara rreth programit televiziv të RTK-së, të cilat janë shumë të rëndësishme për një raport vjetor të Televizionit në përgjithësi.

6.8. SEKTORI I TEKNIKËS NË RTK-TELEVIZION

Sektori i Teknikës ka për detyrë sigurimin e kushteve teknike për realizimin e programeve të ndryshme, mbikëqyrjen teknike të këtyre realizimeve, përkujdesjen teknike gjatë emetimit të programit, mirëmbajtjen e aparaturës për prodhim dhe emetim të programit, si dhe përkujdeset për hartimin dhe realizimin e programeve teknologjike rreth rritjes së kapaciteteve dhe përparimeve teknologjike.

Punëtorët e Teknikës, në të gjitha këto segmente të punës kanë arritur rezultate të kënaqshme. Gjatë vitit 2010 është realizuar tenderi për pjesë ndërrimi dhe aparaturë tjetër të nevojshme.

Gjatë vitit 2010 janë ndërruar tri njësi të montazhit, një gjenerator i ri është vendosur në Studio 1, kurse dy të tjerë janë vendosur në Studio 2 dhe MCR. Me sigurimin e pjesëve të ndërrimit, janë servisuar kamerat e Studiove 1 dhe 2 dhe ato të auto-reportazhit (OBV). Po ashtu, janë servisuar shumica e magnetoskopëve të tipit SX. Për teknikën DV CAM janë siguruar magnetoskopë të rinj (me tenderin e përmendur) për pikat e punës në montazhe AVID, shikim të programit dhe dhoma e bartjes së materialeve.

Gjatë vitit 2010 është intensifikuar procesi i bartjes së video-sinjalit përmes VPN-linjave për IP streaming, duke përdorur edhe kabllon optike të rrjetit të Qeverisë. Duke zbatuar këtë teknologji, është mundësuar fleksibilitet më i madh duke mundësuar realizimin e shumë lidhjeve të drejtpërdrejta për emisione e projekte të ndryshme. Nevojitet që ky segment teknik të konsolidohet sa më shpejt në kuptimin e kompletimit të sistemit me aparaturë të nevojshme dhe me kontrata stabile të huadhënësve të linjave (provajderëve).

Gjatë këtij viti janë blerë dhe janë montuar dy antena satelitore me dimensione më të mëdha (D=3m), të cilat kanë mundësuar cilësi më të mirë të pranimit të programeve satelitore në përgjithësi e sidomos të ndeshjeve nga Kampionati Botëror i Futbollit.

Përveç programeve nga skema e zakonshme, gjatë vitit 2010 janë realizuar me sukses edhe mbulime të ngjarjeve të mëdha vendore dhe të jashtme, ku veçohen:

- Zgjedhjet e përgjithshme,
- Kampionati Botëror i Futbollit,
- Vizitat e personaliteteve të njohura botërore,
- Minisamiti i kryetarëve të shteteve fqinje etj.

Punonjësit e Teknikës, në bisedat vjetore me udhëheqësit e drejtpërdrejtë, kanë paraqitur vërejtje dhe sugjerime (kryesisht kanë të bëjnë me harmonizim dhe rritje të koeficienteve). Nuk janë plotësuar as vendet e punës së punonjësve që janë pensionuar, duke shkaktuar probleme në mbulimin e ndërrimeve. Po ashtu, gjatë këtij viti nuk është organizuar asnjë trajnim i stafit, në kuadër të përgatitjeve për ndërrime teknologjike.

Gjatë vitit 2010 ka pasur mjaft ankesa rreth pranimit të programit satelitor. Këto probleme më së shumti janë shkaktuar për shkak të ndërrimeve që ndodhën pas dështimit të Eutelsatit me satelitin W3. Edhe ngushtimi i brezit frekuencor, për shkak të çmimit më të lirë (dy kontratat e fundit) ka kontribuar që problemet të jenë më të theksuara.

Pavarësisht ecurisë së realizimit të investimit kapital në teknologji, është e domosdoshme të ndahen mjete buxhetore për:

- Kompletimin teknik të sistemit për “lidhje përmes internetit”, që nënkupton lidhjen e dekoderëve dhe marrësve satelitorë në sistem shpërndarës dhe deri te mikseta në ST1 e ST2.
- Operacionalizimin e servisit për teknologjinë digjitale, që nënkupton blerjen e pjesëve dhe instrumenteve të nevojshme që mirëmbajtja ta kryejë punën në kohë optimale.
- Servisimin gjeneral të vijës për transmetim satelitor, duke përfshirë edhe blerjen e amplifikatorit rezervë dhe ndërrimin e akumulatorëve të UPS-it.

6.8.1. NJËSIA E TRANSMETIMIT

Gjatë këtij viti (2010), Njësia e TX, përveç transmetimit dhe monitorimit të programit (RTK-së) ka realizuar edhe transmetime të shumta të drejtpërdrejta të ngjarjeve vendore dhe ndërkombëtare me rëndësi nga politika, sporti, kultura etj. Nga politika janë realizuar nga vendi transmetime të drejtpërdrejta nga Presidenca, Kuvendi, Aeroporti i Prishtinës, selitë e partive politike, salla "1 Tetori", hoteli "Grand", Salla e Kuqe, KQZ-ja etj.

Prej transmetimeve ndërkombëtare janë aranzhuar dhe realizuar teknikisht paraqitje të drejtpërdrejta nga Vjena, Brukseli, Nju-Jorku, Këshilli i Sigurimit (OKB), si dhe paraqitjet e shumta të drejtpërdrejta të reporterëve tanë dhe marrja e materialeve nga qendrat e ndryshme rajonale e botërore për RTK-në.

Nga sporti janë transmetuar nga vendi ndeshje futbollistike, tenis, volejbol, gjysmëmaratona, boks e të tjera, ndërsa ndërkombëtare: Ndeshje futbollistike, Kampionati Botëror i Futbollit, si dhe Liga e Kampioneve, boks etj.

Nga kultura: Panairi i Librit, koncerte, ndërsa nga bota: Koncerti i Vjenës për Vitin e Ri, “Golden Globe”, “Bafta Awards”, Festivali i Filmit - Berlin, Grammy Awards, kënga e Eurovizionit, “Emy Awards”, Festivali i Kanës, gala-koncerti humanitar për Nënë Terezë etj.

Çdo javë janë realizuar paraqitje të drejtpërdrejta për parashikimin e motit. Janë bërë transmetime të drejtpërdrejta me link tokësor nga:

Aeroporti i Prishtinës, Hoteli "Grand", Fakulteti i Filologjisë, Salla e sporteve "1 Tetori", Pallati i Rinisë, Stadiumi i Prishtinës, “Velania”, “Dragodani”, TMK-ja, KFOR-i, Kinemaja ABC, Shkolla “Ismail Qemali” (tenis)

Edhe gjatë këtij viti janë pranuar pandërprerë sinjali i CFI-së dhe VOA (Zëri i Amerikës), lajmet në orën 23:00 të cilat janë rekorduar nga ekipi i TX. Gjithashtu janë pranuar dhe rekorduar edhe sinjale nga TVSH, EBS, BBC, TRT1, EBU (H1) etj.

Njësia e TX ka realizuar transmetime të drejtpërdrejta unilaterale dhe dërgimin e materialeve nga RTK-ja për qendrat e ndryshme televizive botërore.

Këtë vit, për Zgjedhjet 2010 kemi pasur lidhje nga shumë pika, brenda dhe jashtë Prishtinës.

Më poshtë kemi disa të dhëna për transmetimet e realizuara gjatë vitit 2010.

Transmetimi i Kuvendit të Kosovës: 54 herë;
FID për EBU --- 60;
FID për TELEVISIONET e huaja --- 77;
PARAQITJE LIVE për TELEVISIONET e huaja --- 43 herë;
AKADEMI PËRKUJTIMORE --- 12 herë;
TRANSMETIME ME SNG --- 33 herë;
TRANSMETIME TË DREJTPËRDREJTA - Nga Qeveria, Kuvendi dhe sheshi “Nëna Terezë” me COMPLEX;
FIDA TË PRANUAR NGA TV-të E HUAJA --- 43;
PARAQITJET LIVE TË GAZETARËVE TANË NGA JASHTË KOSOVËS --- 57;
TRANSMETIME NGA HAGA --- 2 herë;
LIGA E KAMPIONËVE --- 63 ndeshje;
PËRMBLEDHJET E LIGËS SË KAMPIONËVE --- 53 transmetime (golat);
GJYSMËMARATONA E PRISHTINËS - Transmetim;
VIZITA E HILLARY CLINTON-it NË KOSOVË;
Vizita e kryeministrit të Turqisë në Kosovë;
Transmetimi i faljes së Bajramit;
Transmetimi i meshës së Krishtlindjeve.

6.8.2. Teknika e studios

Gjatë vitit 2010, në Sektorin e Transmetimit të Brendshëm, ku përfshihen 2 studio, MCR, montazhat, si dhe pajisjet e tjera në TV (duke përfshirë FTP, Njësinë e titrimit, Njësinë e kontrollimit të materialeve etj.) është bërë servisimi, mirëmbajtja e pajisjeve, si dhe kontrollimi i procesit të emetimit të programit të drejtpërdrejtë, si dhe programeve që xhirohen në RTK.

Në kuadër të programeve të planifikuara është bërë kontrollimi dhe përgatitja e pajisjeve dhe studiove për edicionet e lajmeve, programit të mëngjesit, emisioneve të drejtpërdrejta dhe xhirimeve, si dhe kontrollimi i pajisjeve të tjera, duke përfshirë Njësitë e montazhit, Njësinë e titrimit, të grafikës, MCR-në etj.

Studio 1:

Është blerë, montuar dhe inkorporuar në sistem Inscribeer cg, janë rregulluar 3 kamerat, ndërsa pajisjeve të tjera u është bërë servisimi periodik. Nevojë urgjente në Studio1 është ndërrimi i kompjuterit të PROMPTERIT, ndërrimi i monitorëve.

Studio 2:

Gjatë vitit 2010 është instaluar çg inca në Studio 2, i cili ka zgjidhur problemin e grafikës, është bërë servisimi gjeneral i audio-mikserit Yamaha, rregullimi i kamerave. Nevojë urgjente paraqitet ndërrimi i kompjuterit të PROMPTERIT, ndërrimi i shumicës së monitorëve.

MCR:

Në MCR gjatë vitit 2010 janë servisuar CG inscriber dhe geevs si pasojë e defekteve në HDD si dhe në power supply. Nevojë urgjente paraqitet ndërrimi i monitorëve, blerja e hdd rezervë.

MONTAZHAT:

Në montazha janë instaluar tri njësi të reja jolineare dhe ato një AVID NITRIS, dhe dy AVID MOJO. Gjatë vitit 2010 është parë nevoja e blerjes së pajisjeve rezervë të njësisve të reja, pasi në vitin e parë të punës janë prishur dy hdd të AVID-it. Gjatë vitit 2011 nevojitet të ndërrohen pjesa e audios në montazhat lineare, mikrofonat, audio-mikserët dhe monitorët.

Mirëmbajtja periodike e pajisjeve është kryer sipas listës së mirëmbajtjes në të cilën përfshihen 30 VTR SX të tipit dn a75p, 8 player dn a-65p dhe 4 dnw a-30p. Në këtë mirëmbajtje përfshihen pajisjet e tipit DV CAM, të cilat janë në Njësitë e montazhit, bartjes dhe atë të kontrollimit.

Si pjesë shtesë e angazhimit gjatë këtij viti ka qenë mbulimi i Kampionatit Botëror të Futbollit, si dhe Zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në dhjetor.

Pajisjet në studio dhe në MCR tashmë e kanë kaluar 10-vjeçarin, d.m.th. janë në eksploatim 24-orësh, 7 ditë në javë, për më tepër se 10 vjet, pa ndryshime rrënjësore. Edhe pse gjendja e tyre, falë servisimeve periodike të mirëmbajtjes, është e kënaqshme, si shkak i ndërrimit të teknologjisë në lëmin e TV-së, nevojitet që të bëhet kalimi në tapeless-teknologji sa më shpejt.

6.8.3. SEKTORI I TRANSMETIMEVE TË JASHTME

Gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2010, në Sektorin e Transmetimeve të Jashtme të Radiotelevizionit të Kosovës, që përfshijnë Autoreportazhin (OB VAN), ENG-kamerat dhe studio-kamerat gjendja ka qenë si vijon:

- AUTOREPORTAZHI (OB VAN) - gjatë periudhës së cekur kohore janë bërë 237 transmetime të drejtpërdrejta apo xhirime në terren, duke përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara teknike dhe profesionale. Gjatë periudhës së përmendur janë bërë dy kontrole gjenerale të teknikës dhe pajisjeve, ku janë bërë testime, akordime dhe riparime të VTR-ve, kamerave, CCU, triaxeve dhe pajisjeve përcjellëse. Në OBV ekziston CHARACTER GENERATORI që është funksional, por ka performancë të dobët. Audio-mikseta YAMAHA si rezultat i amortizimit ka performancë të dobët dhe disa hyrje janë të papërdorshme.

Triaxet si tërësi janë në gjendje të keqe, si pasojë e eksploatimit janë dëmtuar dhe amortizuar dhe kanë defekte të shpeshta. Si tërësi, kjo njësi është në gjendje të mirë dhe ka performancë të mirë pune.

ENG kamerat - kjo njësi ka rreth 30 kamera Eng të tipit DNW 7p, DSR dhe JVC, e të cilat janë në gjendje operative dhe me shkallë relativisht të lartë të amortizimit të aksesorëve të tyre, kurse kamerat JVC, edhe pse janë në rregull, disa prej tyre nuk përdoren për shkak të performancës së dobët.

Skema e projektuar për mirëmbajtje mujore dhe tremujore nuk është realizuar për shkak të mungesës së pjesëve rezervë.

Tripodat, mikrofonat, kufjet, bateritë dhe në përgjithësi aksesorët janë mjaft të amortizuar dhe të dëmtuar.

STUDIO KAMERAT- janë gjithsej 10 kamera dhe 11 CCU. Të gjitha janë në gjendje të rregullt teknike pas riparimeve të kryera me pjesët rezervë të blera në këtë periudhë. Disa nga CCU kanë pasur defekte në borda SDI, por janë riparuar në mënyrë provizore me adapterë SDI. Problem të veçantë në këtë pjesë paraqesin kabllot triax dhe konektorët përkatës që mungojnë, si dhe dorëzat përkatëse të zumave dhe fokuseve për kamera të cilat janë të amortizuara. Janë bërë akordime në kamera dhe CCU.

Krani që përdoret për transmetime të jashtme është shumë i amortizuar. Disa herë është riparuar, por është jashtë përdorimit.

Përfundimisht mund të thuhet se planet e punës në këtë sektor janë realizuar mirë.

Teknologjia që posedojmë është në eksploatim tashmë 10 vjet dhe ka pësuar një shkallë të lartë të amortizimit. Në projeksionet e ardhshme konsiderojmë se duhet të bëhen investime në teknologjitë e reja, aq më tepër, kur merret parasysh fakti se pjesët rezervë që ne i kemi janë në limitet e fundit.

6.8.4. NJËSIA E ENERJTIKËS

Pajisjet dhe stabilimentet të cilat janë në gjendje gatishmërie për punë, si dhe pajisjet elektrike të cilat janë jofunksionale, për arsye të defekteve kapitale, mosfunksionimi për arsye konfigurative dhe kapaciteteve të tyre.

Trafo-fusha e tensionit të lartë 10/04 kV dhe transformatori 630 kVA

Gjatë vitit 2011 është bërë kontrollimi periodik i stabilimenteve në trafostacion, duke përfshirë këtu kthinën e ndarësve të tensionit 10 kV dhe 0,4 kV dhe kthinën ku është vendosur transformatori 630 kV. Ndarësit, si ai 10 kV po ashtu edhe ai 0,4 kV janë në gjendje të mirë pune. Ndërsa në kthinën e transformatorit, më shumë jemi përqendruar në kontrollimin e vajit të trafos, i cili ka qenë në nivelet e parapara normative.

Gjendja në trafostacion është stabile.

Gjeneratorët 315 kVA, 125 kVA dhe 50 kVA

Në rastin kur kemi mungesë të energjisë elektrike nga rrjeti i KEK-ut, atëherë furnizohemi nga burimet alternative, që për ne janë gjeneratorët. Këta gjeneratorë, për të punuar normalisht, duhen të mirëmbahen. Gjatë vitit 2010 është bërë ndërrimi i vajit motorik, filtrave të ajrit, rripave në çdo 200 orë pune, si dhe antifrizi në sistemin ftohës për sezonin janar-dhjetor 2010.

Në gjeneratorin 125 kVA, përveç punëve të lartshënuara, është bërë ndërrimi i radiatorit të ujit me një të ri, i njëjti është vendosur në punë. Njëherësh, për arsye se nxehtësi i ujit të ky gjenerator nuk kishte funksionuar asnjëherë, që nga prodhimi i gjeneratorit, jemi detyruar që të ndërrohet vendi i shtratit të nxehtësit. Po ashtu, është bërë përshtatja e shtratit të nxehtësit me një nxehtës që mund të gjendet edhe në tregun tonë blerës. Pajisja e re funksionon normalisht dhe është bërë një zgjidhje shumë e rëndësishme.

Në gjeneratorin 50 kVA në aneks, është bërë ndërrimi periodik i vajit, filtrave, antifrizit në periudhën janar-dhjetor 2010, duke u bazuar në orët e punës. Gjendja e këtij gjeneratori është stabile.

UPS 315 kVA dhe 20 kVA

Momentalisht UPS 315 kVA është në gjendje pune. Mirëpo, kapaciteti i tij, gjatë punës në bateri, është zvogëluar. Dhe tani në funksion janë dy kumora me nga 35 bateri, ndërsa kumora e tretë nuk është në funksion, d.m.th. nga 105 bateri të nevojshme në punë janë 70 bateri, apo në punë janë 2/3 e kapacitetit të tij. Kjo është pasojë e rrethanave financiare. Njëherësh, duke e shtuar edhe kohëzgjatjen e punës (5-vjeçare) në kushte të vështira gjatë ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike, është e nevojshme të mendohet që në kohë të afërt të intervenohet për furnizimin e baterive të nevojshme për ndërrimin dhe rritjen e kapacitetit dhe sigurisë në punë të UPS-it.

UPS 20 kVA është në gjendje të mirë pune. Gjendja e tillë rezulton për arsye se i njëjti është i lidhur në seri me UPS 315 kVA, i cili ndikon që UPS 20 kVA të punojë pa ndërprerje.

Stabilizuesi 250 Kva

Është në gjendje të mirë funksionale. Ai është në gjendje stand by dhe mund të futet në funksion në çdo kohë, sipas nevojave dhe problemeve që paraqiten me UPS-in në funksion.

Klima (Çileri)

Është jashtë funksionit. Për t'u funksionalizuar duhen investime kapitale. Konsiderojmë se duhet vlerësuar racionalitetin e këtij investimi karshi ndërrimit të tërësishëm të sistemit. Gjatë vitit 2010 është bërë mirëmbajtja e instalimit elektrik në gjithë objektin e RTK-së.

6.9. TV PRODUKSIONI

6.9.1. NUMRI I EMISIONEVE TË REALIZUARA

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL ORË TË REALIZUARA
PCR 1 dhe 2 / xhirimet	65	68	95	86	69	70	59	52	75	82	67	79	867
PCR 1dhe 2 /Drejtperdrejt	15	18	26	47	41	41	32	40	47	43	46	46	442
Autoreportazhi /xhirime	12	15	18	16	13	16	17	9	14	14	21	22	187
Autoreportazhi /drejtpedr.	3	4	7	6	9	3	8	2	5	8	7	8	70

6.9.2. ORËT E REALIZUARA

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
PCR 1 dhe 2 / xhirimet	85.0	82.0	112.0	116.3	112.0	79.4	62.3	54.0	94.0	96.3	86.3	106.3	1085.9
PCR 1dhe 2 /Drejtperdrejt	13.2	19.3	24.2	30.0	23.2	21.1	14.3	21.0	32.2	39.0	46.0	67.0	350.5
Autoreportazhi /xhirime	41.0	45.0	42.0	62.0	49.0	59.0	64.0	21.0	38.0	46.0	128.0	196.0	791.0
Autoreportazhi /drejtpedr.	6.0	7.0	13.0	11.0	14.0	4.0	15.0	2.0	40.0	35.3	24.0	28.0	199.3

6.9.3. PROGRAMET INFORMATIVE - ORËT E REALIZUARA

PËRSHKRIM I	Programi i mëngjesit	INFO - LAJMET 17:00	Lajmet - minoritetet	LAJMET - Qendrore	BLIC - LAJMET 23:00	LAJME 11:00	LAJME 13:00	TOTAL
Janar -Dhjetor /Orë të transmetuara	912.5	70.15	134.5	182.5	92.25	8.2	8.2	1408.3

6.9.4. ORET E REALIZUARA / PKDAF/ PAMS / INFORMATIKA / LAJMET

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
3621.00	3227.00	2639.00	3501.00	3539.00	2234.00	1802.00	1696.00	3793.00	4150.00	3926.00	4108.00	38236.00
3141.00	3141.00	2315.00	3457.00	3232.00	2195.00	1653.00	1559.00	3246.00	4189.00	3118.00	4350.00	35596.00

6.9.5. DIZAJNI GRAFIK

1. Dizajnimi i promove të emisioneve
2. Dizajnimi i siglave: “10 minuta”, “Debat”, “Projeksion”, “E dua muzikën”, Gala-koncertet e RTK-së, Zgjedhjet, programet festive të Vitit të Ri etj.
3. Ndërrimi i identitetit grafik të RTK-së: Siglat e emisioneve dhe të gjitha edicionet e lajmeve.

6.9.6. SKENOGRAFIA

Skenografia për emisionet ”1, 2, 3 fillo”, “Debat”, “10 minuta”, “E dua muzikën”, “Projeksion”, Programi i Mëngjesit, Lajmet 19:30, programet festive të Vitit të Ri (studio dhe eksterier), Zgjedhjet 2010 etj.

7. RADIO KOSOVA DHE RADIO BLUE SKY

7.1. HYRJE

RTK-Radio (Radio Kosova dhe Radio Blue Sky) e ka realizuar planin vjetor për vitin 2010 me rezultate të konsiderueshme sa i përket rritjes së dëgjueshmërisë dhe avancimit të cilësisë programore. Zhvillimet më pozitive janë arritur në pjesën e programit informativ dhe emisioneve muzikore-argëtuese, kurse në pjesët e tjera programore janë evidente ngecje që reflektojnë nivel jo të kënaqshëm të përkushtimit, përgjegjësisë dhe profesionalizmit.

7.2. RADIO KOSOVA

7.2.1. Programi Informativ

Radio Kosova gjatë vitit 2010 ka mbuluar në mënyrë profesionale dhe të gjithanshme zhvillimet më të rëndësishme nga vendi, rajoni dhe bota, duke i ofruar audiencës informim të shpejtë, të balancuar dhe të saktë.

Programi Informativ u ka kushtuar vëmendje të posaçme ngjarjeve e temave të rëndësishme si: përvjetori i dytë i pavarësisë (17 shkurt 2010), dymbëdhjetëvjetori i Epopesë së UÇK-së, fillimi i ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdar (25 prill 2010), ndërhyrja e EULEX-it në Ministrinë e Transportit, për shkak të dyshimeve për korrupsion, vendimi i Tribunalit të Hagës për rigjykimin e pjesshëm të liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj (21 korrik 2010), opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës (22 korrik 2010), kriza institucionale pas dorëheqjes së presidentit të vendit (27 shtator 2010), vizita e Sekretares amerikane të Shtetit, Hillary Clinton, në Kosovë (13 tetor 2010), zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme (12 dhjetor 2010) dhe raporti i Dick Marty-t, raportuesit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Për ngjarjet më të rëndësishme, Radio Kosova ka aplikuar ndryshimin e skemës së rregullt programore dhe realizimin e programeve speciale gjithëditore. Për shënimin e dyvjetorit të pavarësisë së vendit, për programin special më 17 shkurt, janë përgatitur emisione speciale, intervista ekskluzive, reportazhe nga terreni dhe debate të drejtpërdrejta nga ora 07:00 e mëngjesit deri në 01:00 pas mesnate. Ndërkaq, për dymbëdhjetëvjetorin e Epopesë së UÇK-së, përveç përshtatjes me kujdes të Programit Muzikor, Programi Informativ ka mbuluar të gjitha aktivitetet përkujtimore dhe është transmetuar drejtpërdrejt akademia në Prishtinë. Metodë e ngjashme e përgatitjes së programit është aplikuar edhe për fillimin e ndërtimit të autostradës në Vërmicë, opinionin e GJND-së dhe vizitën e Sekretares së Shtetit të SHBA-së në Kosovë.

Në tremujorin e fundit të vitit, Programi Informativ është fokusuar kryesisht në krizën institucionale pas dorëheqjes së presidentit dhe tërheqjes së LDK-së nga koalicioni qeverisës. Kjo temë është ndjekur në vazhdimësi, duke përcjellë ngjarjet e lidhura me të dhe duke analizuar zhvillimet nëpërmjet debateve, intervistave dhe specialeve. Ndërkaq, për mbulimin e Zgjedhjeve të përgjithshme të 12 dhjetorit, Radio Kosova ka formuar ekip të veçantë të gazetarëve, e ka shtuar numrin e edicioneve informative dedikuar fushatës parazgjedhore (kronika zgjedhore) dhe ka realizuar program special në ditën e zgjedhjeve nga ora 07:00 deri në 02:00 pas mesnate. Si një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit, Zgjedhjet 2010 kanë pasur vëmendjen kryesore të Programit Informativ, si para, ashtu edhe pas 12 dhjetorit. Nga monitorimi i KPM-së, Radio Kosova ka dalë me vlerësimet më të mira të mundshme për hapësirën dhe raportimin e balancuar gjatë fushatës parazgjedhore.

Një temë tjetër konstante dhe që ka zënë hapësirë të madhe në Programin Informativ gjatë tërë vitit ka qenë liberalizimi i vizave me BE-në. Të gjitha zhvillimet e sipërpërmendura janë trajtuar gjerësisht edhe në kuadër të emisionit debatues “Forum” dhe në rubrikat e rregullta “Speciale” dhe “Pika mbi I”.

Ndërkaq, sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, Radio Kosova edhe gjatë vitit 2010 ka realizuar emisionet e rregullta me Radio Tiranën (rubrika e përditshme në kuadër të programit të mëngjesit “Një mëngjes tjetër”) dhe Radio Shkupin (emisioni i përjavshëm debatues “Pa kufij”), duke avancuar përmbajtjen tematike dhe rritur audiencën e përbashkët në të tria vendet. Për ta vërtetuar këtë, mjafton të përmendim interesimin e Radios “Deutsche Wele” për të qenë pjesë e emisionit “Pa kufij” dhe nënshkrimin e marrëveshjes me këtë radio në dhjetor 2010. Programi Informativ i Radio Kosovës u ka kushtuar vëmendje të posaçme edhe zhvillimeve në rajon dhe në botë, duke u dhënë hapësirë adekuate sidomos ngjarjeve në Shqipëri dhe Maqedoni.

Gjatë vitit 2010, Programi Informativ ka aplikuar rregullisht edhe transmetimet e drejtpërdrejta, duke u mundësuar dëgjuesve ndjekjen e ngjarjeve kryesore në kohë reale.

Në planin e organizimit të punës, Programi Informativ gjatë vitit 2010 e ka forcuar planifikimin ditor dhe javor. Kujdes të posaçëm i ka kushtuar pasurimit të përmbajtjes në edicionet e lajmeve dhe ka vazhduar me profilizimin e gazetarëve si mënyrë për ngritjen e cilësisë. Si rezultat i këtyre angazhimeve, është vërejtur performancë më e mirë dhe ngritje e disiplinës, ndonëse ende vazhdon të ketë mangësi tek një pjesë e vogël e stafit të gazetarëve.

Me qëllim të organizimit më efikas të punës, në kuadër të Programit Informativ është formuar Redaksia e aktualiteteve, e cila koordinon programin e debateve, ndërsa janë bërë ndryshime pozitive edhe në mënyrën e raportimit të korrespondentëve nga qendra të Kosovës dhe vendet e rajonit.

7.2.2. Emisione dhe programe të tjera

Stabilizimi i skemës programore, gjithëpërfshirja dhe diversiteti në përputhje me detyrimin ligjor për program edukativ e argëtues, përpjekjet e vazhdueshme për ngritjen e cilësisë profesionale dhe konsolidimin e profilit të dallueshëm të Radio Kosovës si “radio për të gjithë”, e kanë karakterizuar pjesën tjetër të programit gjatë vitit 2010. Programi i mëngjesit ka vazhduar me skenar të njëjtë, duke ofruar muzikë të zgjedhur dhe tema servitore nga përditshmëria e qytetarëve. Pjesa më e rëndësishme në kuadër të këtij programi është lidhja e drejtpërdrejtë me Radio Tiranën në rubrikën “Një mëngjes tjetër”, në të cilën shkëmbehen informacionet e para që kanë të bëjnë me përmbajtjen e shtypit ditor, parashikimin e motit, aktivitetet kulturore të ditës dhe kursin valutor. Ndonëse cilësia e prezantimit ende lë për të dëshiruar, gjatë vitit 2010 është vërejtur një dinamikë më e shtuar dhe disiplinë më e madhe në punë.

Programi kulturo-argëtues “ON AIR”, që realizohet çdo ditë nga ora 12:15 deri në 16:00, paraqet pjesën më të pëlqyer për dëgjuesit, gjë që vërtetohet nga interesimi i jashtëzakonshëm i tyre për temat dhe muzikën e transmetuar (numri i sms-ve). Gërshetimi profesional i formatit argëtues me ngjarjet aktuale nga kultura, letërsia, kinematografia, sporti, show-bizz-i etj. i ka bërë dëgjuesit pjesë të pandashme të këtij programi.

Edhe gjatë vitit 2010, Radio Kosova ka aplikuar skemën verore duke rikthyer programin 6-orësh “Vera me Radio Kosovën” gjatë dy ditëve të fundjavës. Ky program ka përmbajtur rubrika të shumta nga fusha e artit dhe kulturës, reportazhe nga vendet më të bukura të Kosovës, nga plazhet e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Turqisë, duke ndikuar në rritjen e mëtejshme të dëgjueshmërisë.

Sa i përket Programit Argëtues, pas sezonit veror është marrë vendim që emisioni “Metropol”, i transmetuar prej disa vitesh në Radion Blue Sky, të transmetohet njëkohësisht edhe në valët e Radio Kosovës. Ky vendim është dëshmuar pozitiv, sepse ka ndikuar në mënyrë të menjëhershme në rritjen e dëgjueshmërisë për të dyja programet e radios.

Hapësirë të rëndësishme në programet e tjera të Radio Kosovës zë edhe Programi Sportiv me dy emisionet kryesore në kuadër të tij “Maratona Sportive” (e shtunë) dhe “Pasditja Sportive” (e diel). Pasurimi i përmbajtjes me rubrika të reja, përveç transmetimeve të drejtpërdrejta të Superligës së Kosovës në Futboll, ka bërë që ky program të jetë platforma më unike për argëtim dhe informim nga sporti. Gjatë vitit 2010, Radio Kosova i ka kushtuar vëmendje të posaçme edhe programit për fëmijë. Përveç emisioneve të rregullta, të cilat tashmë janë konsoliduar sa i përket përmbajtjes, Redaksia e programit për fëmijë ka realizuar me sukses edhe emisione speciale si: 100-vjetori i lindjes së Nënës Terezë, Dita Botërore e Fëmijëve dhe emisione nga kopshte të ndryshme në Kosovë.

Nga ana tjetër, programi arsimor “Eruditio” ka vazhduar të jetë pikë e dobët e programit të Radio Kosovës. Me gjithë temat e larmishme dhe rubrikat e rregullta nga letërsia, gjeografia dhe arti, ky emision nuk ka arritur të nxisë interesim të duhur të dëgjuesve.

Edhe në Programin e Natës ka vazhduar gjendje e njëjtë, pavarësisht numrit në rritje të mysafirëve nga fusha të ndryshme të jetës në Kosovë. Realizimi i Programit të Natës nuk ka pasur ritmin, dinamikën dhe përmbajtjen e duhur për tërheqjen e audiencës së orëve të vona.

Viti 2010 është mbyllur me programin special festiv më 31 dhjetor (i cili ka vazhduar edhe më 1 dhe 2 janar 2011), i përgatitur nga një ekip prej të gjitha redaksive me emisione argëtuese-muzikore, humoristike dhe rubrika e intervista të shumta dedikuar natës më të gjatë të vitit.

7.2.3. Programi në gjuhët e komuniteteve

Gjatë vitit 2010, programi në gjuhët e komuniteteve ka arritur rezultate të kënaqshme në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e materialeve me programin në gjuhën shqipe, ndërsa është përmirësuar dukshëm cilësia e transmetimit të këtyre programeve në internet në ueb-faqen e RTK-së rtklive.com.

Programi në gjuhët e komuniteteve transmetohet në Radio Kosovë në FM për rajonin e Prishtinës dhe në AM (frekuenca 549 KHz), si dhe në Radion Blue Sky në brezin primar. Vlen të theksohet nevoja urgjente për transmetues të ri të valëve të mesme, me qëllim të përmirësimit të sinjalit dhe qasjes më të lehtë të dëgjuesve nga radhët e komuniteteve pakicë në programet e radios.

7.2.4. Programi në gjuhën serbe

Programi në gjuhën serbe transmetohet në Radion Blue Sky çdo ditë nga ora 14:00 deri në 16:00. Përmbajtja e prodhuar nga stafi i redaksisë dhe rrjeti i korrespondentëve ka përmbushur në masë të konsiderueshme kërkesat programore të komunitetit serb në Kosovë. Edicionet e lajmeve dhe rubrikat e rregullta, si pasqyra e shtypit, bota e filmit, kultura, sporti dhe muzika e zgjedhur, kanë përmblyllur një qark programor gjithëpërfshirës dedikuar audiencës serbe në Kosovë.

Zhvillimet kryesore që ka fokusuar programi në gjuhën serbe, gjatë vitit 2010, kanë qenë: përvjetori i pavarësisë më 17 shkurt, fillimi i ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdar, opinioni i GJND-së për pavarësinë e Kosovës, seancat e KS të OKB-së për Kosovën, kriza institucionale pas dorëheqjes së presidentit dhe Zgjedhjet e përgjithshme të 12 dhjetorit. Në mënyrë të posaçme janë fokusuar edhe temat nga përditshmëria nëpër enklava. Korrespondentët e rregullt nga Mitrovica, Prizreni, Leposaviqi, Graçanica, Beogradi dhe Podgorica, kanë arritur rezultate të kënaqshme në cilësinë e raportimit.

7.2.5. Programi në gjuhën turke

Programi në gjuhën turke në Radio Kosovë (nga ora 14:00 deri në 15:00) dhe në Radion Blue Sky (nga ora 16:00 deri në 17:00) ka realizuar të gjitha parashikimet programore me planin e punës të vitit 2010. Stafi i redaksisë dhe korrespondentët e rregullt kanë arritur rezultate të mira në mbulimin e të gjitha ngjarjeve të rëndësishme

nga vendi, rajoni dhe bota, duke fokusuar zhvillimet kryesore politike, ekonomike dhe kulturore të komunitetit turk në Kosovë. Emisionet “Politika Duragi” (Stacioni i Politikës) dhe “Sali Randevusu” (Takimi i së martës) janë realizuar me përkushtim dhe profesionalizëm.

Gjatë vitit 2010 është shtuar bashkëpunimi me programin në gjuhën shqipe, sidomos në shkëmbimin e reportazheve dhe materialeve të tjera nga vizita të rëndësishme politike.

7.2.6. Programi në gjuhën boshnjake

Viti 2010 ka qenë mjaft i suksesshëm edhe për programin në gjuhën boshnjake. Ky program transmetohet nga ora 12:00 deri në 14:00 në valët e Radio Kosovës. Përveç vështirësive në qasjen e dëgjuesve jashtë rajonit të Prishtinës, programi në gjuhën boshnjake nuk ka asnjë problem tjetër.

Përmbajtja e programit me edicionet e lajmeve dhe rubrikat e rregullta nga kultura, arsimit, shkenca dhe muzika e zgjedhur, përmbushin në mënyrë të kënaqshme kërkesat e audiencës boshnjake në Kosovë. Bashkëpunimi i shkëlqyer gjatë vitit me programin në gjuhën shqipe ka ndikuar shumë pozitivisht në përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjes gjithëpërfshirëse të këtij programi.

7.2.7. Programi në gjuhën rome

Edhe programi në gjuhën rome i Radio Kosovës (i cili transmetohet çdo ditë nga ora 15:00 deri në 16:00) ka shënuar rezultate të kënaqshme gjatë vitit. Stafit i redaksisë dhe korrespondentët e rregullt të këtij programi kanë mbuluar me sukses të gjitha ngjarjet kryesore nga vendi, rajoni dhe bota dhe të gjitha aktivitetet e rëndësishme të komunitetit rom, duke fokusuar pozitën e vështirë sociale. Kjo redaksi u ka kushtuar rëndësi të posaçme emisioneve edukative dhe atyre për fëmijë.

Nga zhvillimet kryesore në vitin 2010 veçohet mbulimi profesional i aktiviteteve për Ditën Ndërkombëtare të Romëve (8 prill) dhe koncerti i këngëtares së njohur rome, Esmë Rexhepova, në Prishtinë.

Edhe gjatë vitit 2010 ka vazhduar bashkëpunimi me redaksinë në gjuhën rome të Radios Publike të Suedisë.

7.3. RADIO BLUE SKY

7.3.1. Programi Informativ

Gjatë vitit 2010, Programi Informativ ka intensifikuar përpjekjet për përmbajtje më të gjerë dedikuar moshës së re. Krahas përmbajtjes së njëjtë informative, për shkak të politikës së përbashkët editoriale me Radio Kosovën, stafi i Programit Informativ është angazhuar seriozisht edhe në tema dhe reportazhe që kanë trajtuar problemet, shqetësimet dhe preokupimet e të rinjve në Kosovë, duke fokusuar promovimin e nxënësve dhe studentëve të suksesshëm nëpër shkollat tona.

Sidoqoftë, zhvillimet më të rëndësishme që ka fokusuar edhe Programi Informativ i Radios Blue Sky kanë qenë: përvjetori i dytë i pavarësisë (17 shkurt 2010), dymbëdhjetëvjetori i Epopesë së UÇK-së, fillimi i ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdar (25 prill 2010), ndërhyrja e EULEX-it në Ministrinë e Transportit, për shkak të dyshimeve për korrupsion, vendimi i Tribunalit të Hagës për rigjykimin e pjesëm të liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj (21 korrik 2010), opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës (22 korrik 2010), kriza institucionale pas dorëheqjes së presidentit të vendit (27 shtator 2010), vizita e Sekretares amerikane të Shtetit, Hillary Clinton, në Kosovë (13 tetor 2010), zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme (12 dhjetor 2010) dhe raporti i Dick Marty-t, raportuesit të Asamblesë së Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Por, ndryshe nga Radio Kosova dhe për shkak të profilit të dallueshëm programor si “radio për të rinjtë”, Blue Sky nuk është angazhuar në trajtimin më të gjerë dhe sistematik të temave të sipërpërmendura.

Karakteristikë tjetër e këtij programi është kapaciteti i bashkuar me Radio Kosovën, që ka rezultuar në pasurim të programit, dinamikë të shtuar dhe efikasitet të lartë në punë.

Radio Blue Sky ka vazhduar me konceptin më dinamik të informacionit, me edicione të shkurtra, intervista ekskluzive, speciale dhe materiale të ndryshme tematike, duke arritur rezultate të ndjeshme në rritjen e dëgjueshmërisë gjatë vitit 2010. Në disa sondazhe të bëra prej organizatave të ndryshme në vend, Blue Sky është renditur e treta sa i përket dëgjueshmërisë.

7.3.2. Emisione dhe programe të tjera

Ndryshimet cilësore në skemë dhe përpjekjet sistematike për avancimin e cilësisë profesionale të stafit në realizimin e emisioneve, e kanë karakterizuar vitin 2010 sa i përket pjesës programore të Radios Blue Sky.

Megjithatë, programi i mëngjesit “Mëngjesi Blu” ka vazhduar të mos arrijë dëgjueshmëri të lartë për shkak të formatit jo shumë atraktiv, ndonëse janë bërë përpjekje për rikonceptimin e tij. Ndërkaq, emisioni “Metropol” ka vazhduar të ruajë ritmin dhe dinamikën, duke mbetur shtylla kryesore e rejtingut të radios. Në muajin shkurt, stafi i këtij emisioni ka realizuar transmetimin e drejtpërdrejtë të evenimentit

muzikor “British Awards” dhe ka vazhduar me aktivitetin “Java e Metropolit në Londër”.

Për të rritur dëgjueshmërinë në pjesën e programit që ka pasuar emisionin “Metropol”, është vendosur që nga ora 11:00 deri në 13:00 të startohet me emisionin e ri të formatit të përzier “Mesdita me Blue Sky” (tema të ndryshme, mysafirë në studio dhe vox pop-a), i cili është pritur jashtëzakonisht mirë nga dëgjuesit. Ndërkaq, për ta rikthyer sa më shpejt dëgjuesin pas tri orë programi në gjuhët e komuniteteve, pasdite është futur emisioni i ri 90-minutësh “N’Perëndim me Blue Sky”, i cili përmban informacione të zgjedhura nga bota e show-bizz-it dhe zhvillimet kulturore në vend.

Emisionet kulturore në orët e mbrëmjes dhe programi i natës, i cili është zgjatur për një orë (realizohet çdo natë nga 23:00 deri në 01:00), kanë vazhduar të jenë pa shkallë të lartë të dëgjueshmërisë. Sipas vlerësimeve të redaktorëve, arsyet për këtë gjendje në emisionet e lartpërmendura lidhen kryesisht me nevojën e rishikimit të konceptit dhe me kapacitetet profesionale të stafit të angazhuar në këto emisione. Gjithashtu, programi muzikor që përbën “palcën kurrizore” të programit të Blue Sky ka qenë në nivel jo të kënaqshëm. Kjo për arsye të performancës jo të mirë të stafit të angazhuar në redaksinë e muzikës.

Synimi konstant për një program të pasur dhe cilësor të muzikës së huaj dhe asaj të vendit sipas një planifikimi paraprak, vazhdon të jetë sfida kryesore e programit e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në rejtingun e Radios.

Edhe në Blue Sky, viti 2010 është mbyllur me programin special festiv më 31 dhjetor (i cili ka vazhduar edhe më 1 dhe 2 janar 2011), i cili ka përmbajtur emisione argëtuese-muzikore, humoristike dhe rubrika e intervista të shumta dedikuar natës më të gjatë të vitit.

7.4. TEKNIKA – RTK RADIO

Suksesi më i madh tekniko-teknologjik gjatë vitit 2010 ka të bëjë me fillimin e transmetimit RDS, i cili ka siguruar qasje më të lehtë në programet e Radio Kosovës dhe Radios Blue Sky të dëgjuesve në lëvizje (mjetet e transportit për udhëtarë). Ky sistem bën kalimin automatik të frekuencave të të njëjtit program, pa u hetuar nga dëgjuesi me rastin e kalimit nga një zonë në tjetrën.

Zhvillim i rëndësishëm në këtë sektor është edhe funksionalizimi i audio-arkivit digjital, i cili mundëson ruajtje të sigurt dhe gjetje të lehtë të materialeve të ndryshme sipas nevojës. Ndërkaq, sa i përket digjitalizimit të audio-shiritave ky proces ka arritur në fazën e fundit me fillimin e digjitalizimit të shiritave të audio-arkivit foljor.

Gjithashtu, gjatë vitit 2010, RTK-Radio ka blerë pajisje të reja Handy flash rekorder, me të cilat është rritur dukshëm cilësia e incizimeve të audio-materialeve nga terreni.

8. UEB-FAQJA E RTK-SË

Gjatë vitit 2010, faqja e internetit e Radiotelevizionit të Kosovës, www.rtklive.com, ka mbajtur reputacionin e njërës nga faqet më të vizituara dhe më të besueshme.

Statistikat tregojnë se numri mesatar i vizitorëve gjatë një dite mbetet mbi 40 mijë, me një tendencë ngritjeje, ndonëse tregu dhe konkurrenca në këtë fushë kanë avancuar dukshëm nga koha e fillimeve të tij.

Në punën e rtklive.com, janë respektuar standardet profesionale, duke mbajtur në plan të parë gjithnjë seriozitetin dhe besueshmërinë e informacionit.

Në faqen rtklive.com janë postuar lajmet më të reja nga redaksitë e Televizionit të Kosovës, të Radio Kosovës dhe të Radios Blue Sky, sikundër që janë postuar edhe lajme të tjera nga agjencitë, duke e prezantuar në radhë të parë punën e RTK-së në hapësirën e internetit në mënyrë sa më cilësore.

Në faqen rtklive.com është kultivuar balanca midis përmbajtjeve me tekst dhe ato në video-format, duke e mbajtur ofertën më të pasur në treg për vizitorët në internet.

Ngjarjet dhe zhvillimet kryesore, sikur që ishin Zgjedhjet 2010, janë mbuluar me përkushtim të veçantë, duke respektuar standardet profesionale të RTK-së.

Gjatë vitit 2010, në rtklive.com janë prezantuar në mënyrë të gjithanshme ngjarje e zhvillime ditore nga politika, ekonomia, kultura dhe sporti, nëpërmes rubrikave gjegjëse.

Media të tjera kryesore, sidomos ato të shkruara, kanë shfrytëzuar produktet mediatike të prezantuara në rtklive.com, duke e konsideruar faqen e RTK-së si burim serioz dhe të besueshëm të informacionit publik.

Po ashtu, rtklive.com ka përmbushur në mënyrë të rregullt edhe detyra të tjera të prezantimit të gjithë veprimtarisë së kompanisë.

Gjatë vitit 2010 është diskutuar dhe konceptuar freskimi i dizajnit si dhe begatimi i ofertës sonë mediatike, me përmbajtje argëtuese, e që mbetet të realizohet gjatë vitit 2011.

9. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA

9.1. SHËRBIMI ADMINISTRATIV/KADROVIK RTK-TV

- RTK-TV ka filluar vitin 2010 me gjithsej 313 të punësuar të rregullt me kontrata 3-vjeçare të punësimit;
- RTK-TV ka filluar vitin 2010 me gjithsej 3 të punësuar anëtarë të TOP Menaxhmentit;
- RTK-TV ka filluar vitin 2010 me gjithsej 40 bashkëpunëtorë të jashtëm me kontrata mbi veprën;
- RTK-TV gjatë vitit 2010 ka pasur të angazhuar gjithsej 186 bashkëpunëtorë të jashtëm me kontrata të tjera për bashkëpunim programor;
- RTK-TV projekti televiziv “Familja moderne” gjatë vitit 2010 i ka pasur të angazhuar sipas nevojës së skenarit 26 bashkëpunëtorë të jashtëm, si aktorë, skenaristë, regjisorë, dramaturgë, rekuizitorë, stilistë etj.
- RTK-TV orkestra e RTK-së “BIG BAND” gjatë vitit 2010 i ka pasur gjithsej 21 bashkëpunëtorë/instrumentistë, dirigjentë etj. dhe angazhimi si pjesë e orkestrës i dy të punësuarve të rregullt të Televizionit.
- Projekti programor “Oxygen O2” ka pasur të angazhuar 2 bashkëpunëtorë të jashtëm.
- RTK-TV brenda vitit 2010 ka pasur gjithsej të 358 të punësuar të rregullt, 6 anëtarë të TOP menaxhmentit dhe 12 praktikantë/gazetarë.
- RTK-TV ka përfunduar vitin 2010 me gjithsej 345 të punësuar të rregullt, 12 praktikantë/gazetarë dhe 6 anëtarë të TOP Menaxhmentit.
- RTK-TV ka përfunduar vitin 2010 me gjithsej 14 bashkëpunëtorë të jashtëm me kontrata mbi veprën.
- Në muajin prill janë përgatitur të gjitha kontratat e rregullta për të gjithë të punësuarit për një afat trevjeçar, duke qenë se ato kanë skaduar pas afatit 3-vjeçar.

- RTK-TV për realizimin e projektit për përvjetorin e themelimit të RTK-së, gala-koncerti, ka angazhuar gjithsej 23 bashkëpunëtorë të jashtëm, si: instrumentistë, aranzhues, këngëtarë dhe grupi i korit përcjellës etj.
- Realizimi i projektit të zgjedhjeve “Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010” projekt ky i realizuar gjatë muajit dhjetor 2010. Për realizimin programor ka qenë i formuar ekipi zgjedhor prej gjithsej 54 të punësuarve në krye me udhëheqësin e ekipit.
- Për realizimin e projektit televiziv “Programi festiv i Vitit të Ri 2010” kanë qenë të angazhuar gjithsej 41 bashkëpunëtorë të jashtëm, si: aktorë, moderatorë, regjisorë, grimerë, stilistë, aranzhues, skenaristë etj. dhe angazhimi shtesë i 50 të punësuarve të rregullt.
- Për realizimin e projektit muzikor “E dua muzikën” në korrik 2010 kanë qenë të angazhuar 20 bashkëpunëtorë të jashtëm dhe angazhimi shtesë i 20 të punësuarve.
- Për realizimin e projektit muzikor, koncerti “**Gala**” për nder të këngëtares znj. Nexhmije Pagarusha, kanë qenë të angazhuar 24 bashkëpunëtorë të jashtëm.
- Për projektin programor “**Kurrë më**” kanë qenë të angazhuar 7 bashkëpunëtorë të jashtëm,
- Në RTK-TV, gjatë vitit 2010, janë pensionuar me arritjen e moshës për pensionim, gjithsej 6 të punësuar. Të gjithë të punësuarve të pensionuar u është bërë pagesa e 3 pagave mesatare të vendeve të tyre të punës të tre muajve të fundit.
 1. 2 vozitës,
 2. 1 arkivist,
 3. 1 mjeshtër skene,
 4. 1 depoist,
 5. 1 teknik në energjetikë PKL

RTK-TV gjatë vitit 2010 në bazë të Rregullores për avancime në RTK ka avancuar/risistemuar në shkallë më të lartë të klasës së pagës gjithsej 50 të punësuar, disa prej tyre edhe me risistemim në vende të tjera pune brenda RTK-së, 2 të punësuar janë risistemuar prej RTK-Radios dhe 1 i punësuar është degraduar në pozitë, me vetëdëshirë (me reflektime në pagë).

- RTK-TV gjatë vitit 2010 ka konvertuar prej kontratës mbi veprën ose bashkëpunim programor, në kontratë të rregullt të punësimit me afat trevjeçar, gjithsej 34 bashkëpunëtorë të jashtëm.
- RTK-TV ka përgatitur gjatë vitit 2010 gjithsej 18 vendime për ndihma solidare për të punësuarit në bazë të Kontratës Kolektive të RTK-së, për raste të ndryshme, si: raste të vdekjes së të punësuarit, raste të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, raste të sëmundjes së rëndë të punësuarit dhe raste të sëmundjes së rëndë të anëtarëve të ngushtë të familjes.
- **RTK-TV ka përgatitur kontratat për bashkëpunim programor, me producentë të pavarur, si:**
 - "Cak Consulting" - cikli i emisioneve "Një frymë";
 - Memorandum bashkëpunimi me James Berisha;
 - DPT - "Klaster";
 - NPSH "Alaron" - cikli i emisioneve "Kodi SHOW";
 - PR Solutions - për emisionin "Avenye";
 - OJQ "Handicap Kosova" - cikli i emisioneve "Mundësi";
 - NSH "Ajo Pictures" - filmi dokumentar "Gjurmët e humbura";
 - Produksioni muzikor "Okteti PLUS" - angazhimi për komentimin e mbrëmjes finale të "Evrovizionit";
 - Produksioni muzikor "Okteti PLUS" - angazhimi në projektin muzikor "E dua muzikën";
 - NTP "Oaza" - blerja e dhuratave për fëmijë për Vitin e Ri 2010;
 - Klubi basketbollistik "Sigal Prishtina" - transmetimi i ndeshjes;
 - OJQ. "Tradita" filmi-komedi "Mos e prek";
 - ShPK "Servisi i gjeneratorëve" - huazimi i gjeneratorit;
 - "The agency productions" - cikli i emisioneve "Sve je moguće sa Anom";
 - NSH "IliraFilm&Teatër" - filmi dokumentar "Një rrëfim për nënën";
 - OJQ ART Univerzal "UniART" - cikli i emisioneve dokumentare "Luftë për jetën";
 - Produksioni muzikor "CORONA" - orkestrimi i këngëve për Koncertin "GALA";
 - DPT "Klaster" - incizimi i këngëve për nevoja programore të televizionit;
 - DPT "Klaster" - realizimi i CD-së me muzikë instrumentale për nevoja programore të Televizionit;
 - NSH "Lighting Design Studio" - shërbimet teknike për ndriçim;
 - "Filharmonia - Opera e Kosovës";
 - NSH "Art-4production" - filmi dokumentar "Mendje ndrituri sojnik";
 - NSH "C.S.O. Solution" - shërbimet teknike për përkthim simuluan;
 - Zyra për përkthime "ENOR" - përkthime të filmave, serialeve etj.;
 - Produksioni muzikor "Kroni" - cikli i emisioneve muzikore "Folk SHOW";
 - "Kosova production" - cikli i emisioneve "Afër";
 - NSH "ORION" - cikli i emisioneve për fëmijë "Super GOGO";

RTK-TV gjatë vitit 2010 ka rekrutuar me procedurë të rregullt të konkursit gjithsej 14 të punësuar të rregullt, prej tyre 4 emërimë sipas ligjit, në pozita menaxheriale, si dhe 2 bashkëpunëtorë të jashtëm:

- Drejtor i Përgjithshëm - 1 pozitë;

- Drejtori i RTK-Televizionit - 1 pozitë,
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm - 2 pozita;
- Lektor - 3 pozita;
- Vozitës - 1 pozitë (konkursi i vitit 2009);
- Redaktor i muzikës - 1 pozitë (konkursi i vitit 2009);
- Bashkëpunëtor profesional për arkiv - 1 pozitë;
- Bashkëpunëtor i jashtëm në cilësinë e gazetarit - 2 pozita;
- Zyrtar ligjor 2 - 1 pozitë, (konkursi i vitit 2009);
- Udhëheqës i marketingut -1 pozitë;

Sqarim:

- pozita e Drejtorit të Përgjithshëm ka qenë rekrutim i brendshëm me procedurë të konkursit publik;
- 2 pozitat e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm kanë qenë rekrutim i brendshëm me procedurë të konkursit publik;
- Pozita e bashkëpunëtorit profesional për arkiv ka qenë rekrutim i bashkëpunëtorit të jashtëm me procedurë të konkursit të brendshëm.

Me procedurë të rregullt të konkursit dhe në bazë të Rregullores së brendshme për arsimim janë rekrutuar me procedurë të rregullt të konkursit publik 12 praktikantë/gazetarë.

Pa procedurë të konkursit është angazhuar një bashkëpunëtor i jashtëm me kontratë mbi veprën redaktor-gazetar në ueb-faqe - 1 pozitë.

RTK-TV gjatë vitit 2010 ka shkëputur 5 kontrata mbi punësimin në këto vende të punës, me kërkesë të të punësuarve, si:

- 1 udhëheqës i njësisë së tonit
- 1 gazetar
- 1 gazetar-redaktor
- 1 gazetar i sportit
- 1 gazetar 2

Me vdekje të të punësuarve si:

- 1 VT-Operator në bartje

Sqarim:

- Nuk është bërë vazhdimi i kontratës pas skadimit të mandatit të u.d. të Drejtorit të Përgjithshëm dhe u.d. të Drejtorit të RTK-Televizionit - 1 pozitë;
- Është shkëputur një kontratë e marrëdhënies së punës me u.d. të kryeredaktorit në RTK-Televizion - 1 pozitë, për shkak të emërimit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm,
- Është shkëputur një kontratë e marrëdhënies së punës me u.d. të redaktorit 1 në RTK-Televizion - 1 pozitë, për shkak të emërimit në pozitën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm.

RTK-TV gjatë vitit 2010 ka publikuar këto konkurse për këto vende të pune, si:

- Drejtor i Përgjithshëm - 1 pozitë (në fund të vitit 2009 afati i konkursit deri më 2010);
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm - 1 pozitë;

- Drejtor i RTK-Televizionit - 1 pozitë;
- Kryeredaktor - 1 pozitë;
- Lektor - 3 pozita;
- Gazetar 2 - 2 pozita;
- Gazetar-praktikant - 10 pozita;
- Udhëheqës i shërbimit të marketingut - 1 pozitë;
- Depoist - 1 pozitë;
- Zyrtar i marketingut - 4 pozita;
- Asistent i marketingut - 2 pozita.

Në RTK-TV kanë mbetur këto konkurse të paproceduara për këto vende të lira të punës:

Konkurset në procedim janë:

- Zyrtar i marketingut - 4 pozita (në procedim)
- Asistent i marketingut - 2 pozita (në procedim)
- Kryeredaktor në RTK-Televizion - 1 pozitë (në procedim)
- Depoist - 1 pozitë (në procedim)

Janë zhvilluar takime zyrtare me Zyrën ligjore të MPMS-së, lidhur me dispozitat e Ligjit të ri të Punës në Kosovë, reflektimin e tyre në rregulloret e brendshme të RTK-së dhe kontratat e rregullta dhe kontratatave mbi veprën.

Është punuar në mënyrë intensive edhe në propozimet për ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe kontratat e punës dhe atyre mbi veprën, menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të Punës në Kosovë, në bazë të sugjerimeve dhe rekomandimeve të Zyrës ligjore të MPMS-së.

Janë përgatitur mostrat e kontratave në bazë të mostrave obligative të MPMS-së, duke i harmonizuar me kërkesat e specifikave të mediumit publik me dispozita të reja.

Janë zhvilluar takime zyrtare dhe kontakte të përhershme edhe me zyrtarët gjegjës të MASHT-it rreth verifikimit të diplomave të ndryshme që janë sjellë nga të punësuarit në RTK.

9.2. SHËRBIMI ADMINISTRATIV/KADROVIK NË RTK-RADIO

RTK-Radio ka filluar vitin 2010 me gjithsej 139 të punësuar të rregullt me kontrata 3-vjeçare të punësimit;

RTK-Radio ka filluar vitin 2010 me gjithsej 31 kontraktues me kontrata mbi veprën;

- RTK-Radio gjatë vitit 2010 ka pasur të angazhuar gjithsej 78 bashkëpunëtorë të jashtëm me kontrata për bashkëpunim programor;
- RTK-Radio brenda vitit 2010 ka pasur gjithsej 164 të punësuar të rregullt dhe 1 anëtar të Menaxhmentit të Lartë.
- RTK-Radio ka përfunduar vitin 2010 me gjithsej 164 të punësuar të rregullt dhe 1 anëtar të Menaxhmentit të Lartë.
- Realizimi i projektit të zgjedhjeve “Zgjedhjet parlamentare në Kosovë 2010”, projekt ky i realizuar për një periudhë të caktuar kohore prej 01.12.-31.12.2010. Për realizimin programor ka qenë i formuar ekipi zgjedhor prej gjithsej 32 të punësuarve të rregullt dhe 15 të angazhuarve me kontrata mbi bashkëpunimin programor, kryesisht korrespondentë nga Kosova.
- Për realizimin e projektit “Programi festiv i Vitit të Ri 2011” kanë qenë të angazhuar gjithsej 24 të punësuar të rregullt.
- Gjatë vitit 2010, në RTK-Radio janë pensionuar gjithsej 2 të punësuar.
- RTK-Radio gjatë vitit 2010 në bazë të Rregullores për avancime në RTK ka avancuar në shkallë më të lartë të klasës së pagës gjithsej 17 të punësuar, disa prej tyre edhe me risistemim në vende të tjera pune brenda RTK-së.
- Janë risistemuar gjithsej 4 të punësuar në vende të tjera të punës brenda RTK-së, disa prej tyre edhe me reflektime në pagë.
- RTK-Radio gjatë vitit 2010 ka avancuar në kontratë/konvertuar prej kontratës mbi veprën në kontratë të rregullt të punësimit gjithsej 24 kontraktues.
- RTK-Radio gjatë vitit 2010 ka avancuar në kontratë/konvertuar prej kontratës mbi bashkëpunimin programor në kontratë të rregullt të punësimit gjithsej 3 kontraktues.
- RTK-Radio ka shqiptuar gjithsej 5 vendime për masa disiplinore në bazë të Rregullores për përgjegjësi materiale dhe disiplinore në RTK.

RTK-Radio, gjatë vitit 2010, ka rekrutuar me procedurë të rregullt të konkursit gjithsej 6 të punësuar të rregullt, si:

- 1 teknik i zërit 2
- 1 mirëmbajtës i objektit
- 1 pastruese
- 1 vozitës
- 1 lektor
- 1 gazetar 2/ Redaksia për komunitete - gjuha serbe

RTK-Radio, gjatë vitit 2010, ka shkëputur 5 kontrata mbi punësimin dhe 1 kontratë mbi veprën.

Risistemim në vende të tjera të punës në RTK-TV me kërkesë të të punësuarve, si:

- 1 redaktor përgjegjës i Programit Informativ në Radio Kosovë
- 1 redaktor përgjegjës i Programit Informativ në Radio Blue Sky
- 1 redaktore e Redaksisë 2/ Redaksia për komunitete - gjuha serbe
- 1 rojë sigurimi

Me vdekje të të punësuarve si:

- 1 gazetar-redaktor në ueb-faqe
- 1 rojë sigurimi (kontratë mbi veprën)

Gjatë vitit 2010, pas arritjes së moshës 65-vjeçare, janë pensionuar gjithsej 2 të punësuar të rregullt, si:

- 1 teknik në mirëmbajtje të aparaturës
- 1 teknik në energjetikë

Të gjithë të punësuarve të rregullt që janë pensionuar u është bërë pagesa e 3 pagave mesatare të vendeve të tyre të punës të tre muajve të fundit.

RTK-Radio, gjatë vitit 2010, ka publikuar këto konkurse për këto vende pune, si:

- 1 teknik i zërit 2
- 1 mirëmbajtës i objektit
- 1 pastruese
- 1 vozitës
- 1 lektor
- 1 gazetar 2 / Redaksia për komunitete – gjuha serbe

Janë formuar katër vende të reja të punës, si:

Audio-arkivist në Radio, korrespondent (këto vende të punës ende nuk janë plotësuar) dhe bashkëpunëtor i muzikës dhe kryeteknik në Produksion, të cilat janë plotësuar prej burimeve të brendshme të RTK-Radios.

9.3. SHËRBIMI I TI-SË

Gjatë vitit 2010, Shërbimi i TI-së u është përgjigjur të gjitha kërkesave për ndihmë nga ana e të punësuarve të RTK-së, si dhe është përkujdesur për mbarëvajtjen e punës së sistemit (dhomës së serverëve) në tërësi, duke shënuar kështu një vit mjaft të suksesshëm, pa probleme serioze. Kërkesa për intervenime gjatë këtij viti ka qenë dukshëm më e lartë, krahasuar me një vit më parë (rreth 2000 intervenime më tepër).

9.3.1. Njësia e TI-së në Radio

Gjatë vitit 2010, Njësia e TI-së në Radio ka intervenuar tërësisht në rreth 2262 probleme, të cilat klasifikohen në tri grupe, si: intervenime të lehta 1046, intervenime të mesme 822 dhe intervenime komplekse 394.

Muaji	Ditët e punës	Intervenime mesatare gjatë ditës	Totali i intervenimeve gjatë muajit	Intervenime të lehta	Intervenime të mesme	Intervenime komplekse
Janar	20	8	160	64	73	23
Shkurt	19	11	209	105	69	35
Mars	23	7	161	58	61	42
Prill	22	11	242	118	88	36
Maj	21	9	189	91	58	40
Qershor	22	7	200	120	63	17
Korrik	22	6	132	66	47	19
Gusht	22	7	154	61	58	35
Shtator	23	10	230	99	82	49
Tetor	21	9	189	89	77	23
Nëntor	22	11	242	113	83	46
Dhjetor	22	7	154	62	63	29
Totali	259	103	2262	1046	822	394

Në grupin e intervenimeve të lehta i kemi renditur këto punë:

Incizimi i CD-ve, probleme me maus, probleme me tastierë, probleme me furnizim me energji elektrike, probleme me dëgjuese, probleme me bokse, ndërrimi i pasvordëve, probleme me e-maila etj.

Në grupin e intervenimeve të mesme i kemi renditur këto punë:

Probleme me audio-fajlla, probleme me drajverë, probleme me programe aplikative. Më saktësisht në këtë grup i kemi radhitur të gjitha problemet me softuerët të cilët i përdorim për punë të përditshme në RTK-RADIO.

Në grupin e intervenimeve komplekse i kemi renditur këto punë:

Formatizimi i PC-ve, ndërrimi i pjesëve të prishura, intervenime të ndryshme në (Matherboard, UPS etj). Më saktësisht në këtë grup i kemi radhitur të gjitha problemet me harduerin, të cilin e kemi në përdorim për punë të përditshme në RTK-RADIO.

Shërbimi i TI-së në Radio gjatë këtij viti ka përfunduar kabllimin /infrastrukturën e plotë të katit të 5-të të objektit, duke përgatitur kështu zyrat për njësinë e re të marketingut.

Punë të tjera të përditshme me rëndësi të mirëmbajtjes në këtë shërbim kanë qenë edhe:

- Mirëmbajtja e serverit të Radios (Domain Controller);
- Mirëmbajtja e proxy-serverëve, përmes të cilëve menaxhohet shpërndarja e internetit;
- Mirëmbajtjen e konzol-serverit, me të cilin mbrohet rrjeti kompjuterik nga viruset e ndryshëm;
- Mirëmbajtja e serverëve të dy radiove tona me dëgjueshmëri përmes internetit;
- Mirëmbajtja dhe monitorimi i programeve radiofonike përmes incizimit në tre kompjuterë;
- Mirëmbajtja e arkivit muzikor.

9.3.2. Njësia e TI-së në TV

Njësia e TI-së në objektin e TV-së, gjatë vitit 2010, ka intervenuar tërësisht në rreth 5169 probleme, të cilat klasifikohen në tri grupe si: intervenime të lehta 2409, intervenime të mesme 1816 dhe intervenime komplekse 944.

Muaji	Ditët e punës	Intervenime mesatare gjatë ditës	Totali i intervenimeve gjatë muajit	Intervenime të lehta	Intervenime të mesme	Intervenime komplekse
Janar	31	14	434	248	136	50
Shkurt	28	15	420	204	150	66
Mars	31	14	434	217	155	62
Prill	30	15	450	210	160	80
Maj	31	17	527	180	205	142
Qershor	30	13	390	150	180	60
Korrik	31	12	372	190	110	72
Gusht	31	12	372	200	90	82
Shtator	30	13	390	210	120	60
Tetor	31	13	403	190	110	103
Nëntor	30	15	450	200	180	70
Dhjetor	31	17	527	210	220	97
			5169	2409	1816	944

Në grupin e intervenimeve të lehta i kemi renditur këto punë:

Probleme me printerë, probleme me maus, probleme me tastierë, riemërim të monitorimit, probleme me furnizim me energji elektrike, hapja e pin-kodeve telefonike, probleme me dëgjuese, ndërrimi i pasvordëve, probleme me e-mail-outlook express, pastrimi i kompjuterëve - disk cleanup, defragmentimi, disk space, përditësime të ndryshme, problemet me rrjete etj.

Në grupin e intervenimeve të mesme i kemi renditur këto punë:

Probleme me drajverë, probleme me programe aplikative, punët me sistemin e raporteve telefonike mujore, problemet me aparate telefonike, programimi i centralit telefonik dhe instalimet e lidhjeve telefonike dhe kompjuterit. Më saktësisht, në këtë grup i kemi radhitur të gjitha problemet me softuerët, të cilët i përdorim për punë të përditshme në RTK-TV.

Në grupin e intervenimeve komplekse i kemi renditur këto punë:

Formatizimi i PC-ve, ndërrimi i pjesëve të prishura në serverë të ndryshëm, intervenime të ndryshme në motherboard, switchave, hapja e klientëve të rinj në DC dhe atributet, caktimi i filterëve të ndryshëm në disa serverë, rrjetet e reja, wireless, në pajisje kompjuterike televizive, si inscriber, autoque, video server etj, më saktësisht në këtë grup i kemi radhitur të gjitha problemet me harduerin, të cilin e kemi në përdorim për punë të përditshme në RTK-TV.

Punë të tjera të përditshme me rëndësi të mirëmbajtjes në këtë shërbim kanë qenë edhe:

Mirëmbajtja e serverit të rtkit.local (Domain Controller);

Mirëmbajtja e proxy-serverëve, përmes të cilëve menaxhohet shpërndarja e internetit;

Mirëmbajtja e konzol-serverit, me të cilin mbrohet rrjeti kompjuterik nga viruset e ndryshëm;

Mirëmbajtja e serverëve File, ftp, sql,

Mirëmbajtja e sistemit të TV-monitorimit

Mirëmbajtja e softuerit të centralit telefonik dhe sistemit të tarifimit

Shërbimi i TI-së në TV, edhe gjatë vitit 2010, ka asistuar në projekte të ndryshme në TV, si në realizimin e transmetimit të drejtpërdrejtë përmes fibrës optike nga pika të ndryshme të Kosovës për zgjedhjet e 2010-s, intervenime në pajisje të ndryshme të kompjuterizuara të TV Teknikës, si autoque, njësi të montazhit Avid, njësi të montazhit dhe grafikës etj.

9.3.3. Zhvillimet në TI gjatë vitit 2010

Gjatë vitit 2010, Shërbimi i TI-së ka qenë pjesë përbërëse e grupit për digjitalizim, për planifikim dhe përpilim të projektit, i cili më tutje, për shkaqe financiare, nuk është realizuar. Ky projekt është i gatshëm dhe me disa intervenime minimale (aplikimi i zhvillimeve më të fundit) mund të zbatohet.

Ndër projektet që vlen të përmendet është edhe marrëveshja e RTK-së me Ministrinë e Shërbimeve Publike për përdorim të fibrës optike qeveritare, me qëllim të realizimit të transmetimeve dhe bartjes së AV materialit. Shërbimi i TI-së ka qenë pjesë e grupit punues.

Gjatë vitit 2010, Shërbimi i TI-së ka përfunduar të gjitha fazat e ndërlidhjes së dy objekteve të RTK-së përmes fibrës optike, duke përgatitur terrenin kështu për zhvillim të mëtutjeshëm. Fibra e RTK-së që lidh dy objektet përbëhet nga 48 fije optike.

Ndër projektet që vlen të përmenden, gjatë 2010-s, të realizuara nga ana e Shërbimit të TI-së është edhe loja shpërblyese e realizuar për finalen e Botërorit 2010, gjatë së cilës RTK ka dhuruar një veturë (përmes sponsorimit) shikuesit të Botërorit.

Ndër projektet e tjera të rëndësishme gjatë 2010-s ka qenë edhe ndërtimi i sistemit automatik për printimin e ID kartelave moderne. Ky shërbim i TI-së është realizuar në bashkëpunim me shërbimin e sigurimit.

Njësia e zhvillimit aplikativ në kuadër të TI-së gjatë vitit 2010 ka realizuar mirëmbajtje të suksesshme të moduleve të intranetit të ndërtuara tash e 3 vjet. Asnjë defekt në module nuk ka zgjatur më tepër se 12 orë.

Gjatë 2010-s, në kuadër të intranetit janë shtuar edhe 3 module të reja si: moduli për ID-kartela, moduli për detyra dhe punë (Task manager) dhe moduli për pasuri. Disa nga këto module janë në përdorim të plotë, ndërsa disa ende në zhvillim e tutje.

9.3.4. Njësia e uebit

Njësia e uebit, stafi për zhvillim në rtklive.com, gjatë tërë vitit ka realizuar të gjitha detyrat në baza ditore, zhvillimi dhe mirëmbajtja e ueb-faqes rtklive.com kërkon punë të vazhdueshme gjatë vitit, duke u kujdesur rreth dizajnit, freskimit të kërkesave dhe mbikëqyrjes rreth sulmeve të ndryshme.

Intervenime të ndryshme në rtklive.com

- Përpunim të fotografive
- Ndërimi i promote gjatë javës
- Publikime të konkurseve të Televizionit dhe Radios
- Publikim apo ndryshim në marketing
- Hapje të emailave
- Ndërim të pasvordëve

Video-incizimet

Lajmet E Mëngjesit, Info, Haber, Vijesti, Vesti, Mostovi, Lajmet Qendrore, Sport Plus, Familja Moderne, Kafeneja Jonë, Jeta Në Kosovë, Yekhipe, Oxygen Show, Intervista , Pa Rrotlla, Debat, Subvencion, Evropa Më Afër, 10 Minuta, Telekino, Speciale.

Ueb-faqja “Afrika e Jugut 2010”

Në kuadër të ueb-faqes rtklive.com kemi dizajnuar dhe zhvilluar një faqe komplet të re për kampionatin botëror “Afrika e Jugut 2010”.

Në këtë modul të faqes gjenden shumë informata të rëndësishme për kampionatin botëror si:

- Lajme rreth ndeshjeve
- Kalendari i ndeshjeve
- Rezultatet
- Tabelat e ndeshjeve të ndara në grupe
- Anketa se kush do ta fitojë Botërorin 2010
- Komplet dizajn i ri me përshtatje të dizajnit Botërori 2010

Përpos këtyre informatave të nevojshme për shfrytëzuesit dhe adhuruesit e futbollit në rtklive.com/boterori2010, vizitorët janë informuar me një përmbledhje lajmesh rreth ngjarjeve në Kampionatin Botëror.

Një numër i madh vizitorësh kanë votuar në anketën e cila gjendej në modulën për Botërorin 2010, në pyetjen se kush do ta fitojë titullin e kampionatit botëror, ku gjithsej kanë votuar 9327 persona.

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky

Duke u bazuar në kërkesat e dëgjuesve tanë në rtklive.com kemi ndryshuar formatin e dy radiove në internet, kemi kaluar prej formatit Winamp në atë Flash Player për dëgjimin më të lehtë online, duke pasur parasysh se Flash Player ka pothuajse secili kompjuter, i cili ka sistem operativ Windows, mirëpo e kemi lënë opsionin edhe për dashamirët e dëgjimit të radios përmes aplikacionit Winamp.

Çmimi “Rudolf Sopi - Rudi 2011”

Është ndërtuar faqe për çmimin prestigjioz “Rudolf Sopi - Rudi 2010”, ku gjenden informatat rreth pjesëmarrjes në konkurs për kamerën më të mirë të vitit 2010.

Njoftime publike

Kategoria “Njoftime publike” përmban material që Radiotelevizioni i Kosovës ka obligim ta publikojë online. Këtu hyjnë konkurset e RTK-së, si vendet e lira të punës, blerja e veprave audio-vizuele nga producentët e pavarur, konkurset për çmimin “Rudolf Sopi – Rudi”, publikimet e Komisionit Evropian etj.

Vizitueshmëria

Nëse e shikojmë trafikun e gjithëmbarshtëm në bazë të vizitorëve, atëherë rtklive.com ka 53.000 deri në 67.000 vizitorë në ditë që është trafik normal ditor. Në anën tjetër, nëse e shikojmë numrin e klikimeve duke pasur parasysh që secili vizitor mesatarisht navigon brenda ueb-faqes 7 deri në 10 lidhje për informacione të ndryshme, atëherë arrihet numri afër gjysmë milioni klikimesh në ditë.

9.4. ZYRA LIGJORE

Gjatë vitit 2010, janë përcjellë dhe RTK-ja është përfaqësuar në gjithsej 10 (dhjetë) çështje juridike.

1. Pjesëmarrja në shqyrtimin kryesor, më 15.09.2010 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në çështjen juridike – kompensim dëmi. E paditura RTK-ja. Në shqyrtimin kryesor i autorizuari i paditësit ka tërhequr padinë.
2. Pjesëmarrja në shqyrtimin kryesor, më 04.10.2010 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në çështjen juridike – anulim të marrëveshjes. E paditura RTK-ja. I autorizuari i paditësit, në shqyrtimin kryesor ka tërhequr padinë.
3. Në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, më 18.10.2010, RTK-ja ka ngritur padinë në çështjen juridike – Pagimin e borxhit nga Kontrata mbi Shërbimin. Shqyrtimi kryesor ka përfunduar, pritet vendimi i Gjykatës.
4. Më 14.10.2010 nga ana e RTK-së është ushtruar Ankesë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë në çështjen juridike të paditësit (ish-punëtor i RTP-së) - për pronësi. RTK ende nuk ka marrë ndonjë përgjigje.
5. Çështja juridike - për anulimin e tenderit “Sigurimi Shëndetësor” në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. E paditura RTK-ja. Gjykata Ekonomike lidhur me padinë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Në këtë Aktgjykim paditësi ka ushtruar Ankesë në Gjykatën Supreme. Në këtë ankesë nga ana e RTK-së, është paraqitur Përgjigje në Ankesë.
6. Çështja juridike – kompensim në emër të dëmshpërblimit, në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. E paditura RTK-ja. Gjykata Ekonomike lidhur me padinë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Në këtë aktgjykim paditësi ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Në këtë ankesë nga ana e RTK-së, është paraqitur Përgjigje në Ankesë.
7. Çështja juridike, për shkeljen e së drejtës së autorit – shpërblim dëmi, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. E paditura RTK-ja. Seanca e radhës më 28.04.2011.

8. Në Gjykatën Komunale në Prishtinë, është ushtruar padi nga ana e RTK-së, në çështjen juridike – kthimi i shumës së të hollave të fituara pa bazë juridike. Nuk kemi marrë ende ndonjë përgjigje.
9. Përpilimi i ankesave kundër vendimeve të Këshillit të KPM-së drejtuar Bordit të Ankesave për Media të KPM-së.
10. RTK-ja më 09.02.2011 ka parashtruar kërkesë për shqyrtimin procedural të Vendimeve të Bordit për Ankesa dhe Media të datës 11.01.2011, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Nuk kemi marrë ende ndonjë përgjigje.

Inkorporimi dhe harmonizimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212

Janë inkorporuar dispozitat ligjore të Ligjit të Punës në Rregulloret e brendshme të RTK-së dhe në Kontratën Kolektive.

Ndryshimet janë inkorporuar në:

Rregulloren për orarin dhe evidencë në punë;

Rregulloren për përgjegjësi materiale dhe disiplinore;

Rregulloren për honorarë;

Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

Kontratat e marrëdhënies së punës dhe kontratat për punë dhe detyra specifike.

Sipas kërkesave të parashtruara, janë bërë interpretime të ndryshme ligjore, shqyrtime të kërkesave të ndryshme, si dhe përpilime të vendimeve të ndryshme.

Janë përpiluar kontrata të ndryshme për bashkëpunim, për shërbim, si dhe memorandumet e bashkëpunimit.

Korrespondencë me institucione të ndryshme.

9.5. NJËSIA E ARSIMIMIT DHE TRAJNIMEVE

9.5.1. Përmbledhje e përgjithshme

Planifikimi i trajnimeve dhe arsimimit për vitin 2010, është bërë në fillim të vitit, dhe është plotësuar më vonë nga kërkesat e punëtorëve, të nxjerra nga bisedat vjetore.

Një hap pozitiv është bërë me fillimin nga puna të Qendrës për Aftësim Profesional të RTK-së, por edhe aty ka pasur parregullsi, neglizhencë dhe përplasje politikash.

Krahasuar me vitet e mëparshme, më shumë vijues kanë ndjekur trajnime në Kosovë dhe jashtë, duke iu dhënë prioritet sidomos trendëve aktualë teknologjikë: procesit të digjitalizimit, gazetarisë televizive, integriteteve evropiane etj.

9.5.2. ARSIMIMI 2010

Në fushën e arsimimit formal, RTK-ja nuk ka financuar studimet e të punësuarve të saj. E vetmja marrëveshje për financimin e studimeve të të punësuarve mbetet ajo me Universitetin AAB Riinvest. Marrëveshja parasheh kryerjen e studimeve në afat trevjeçar, aq sa zgjasin studimet themelore, dhe në afat dyvjeçar për studimet master. Me të gjithë të punësuarit RTK-ja ka të nënshkruar kontratën mbi arsimim.

Praktikisht, nga të dhënat e administratës së Universitetit AAB Riinvest, del se 66 studentë i kanë përfunduar studimet deri më tani, 12 ende kanë provime të mbetura, ndërsa 3 kanë ndërprerë studimet.

9.5.3. TRAJNIMET

Në vitin 2010, të punësuarit e RTK-së kanë pasur mundësi të ndjekin një sërë trajnimesh. Me gjithë kufizimet buxhetore, trajnimet kanë qenë të orientuara kryesisht në fushat me prioritet, si digjitalizimi.

Në muajin janar, tre gazetarë të Radios kanë ndjekur trajnimin “Gjyqësia” të organizuar nga AIM. Në shkurt, organizuar nga AIM, dy gazetarë të Radios kanë ndjekur trajnimin “Korrupsioni në Kosovë”, ndërsa në muajin mars trajnimin në temën: ”Roli i faktorit ndërkombëtar në veri të Kosovës (ICO, EULEX)”. Dy gazetarë të Radios kanë ndjekur një trajnim për mbrojtjen e ambientit në Budvë të Malit të Zi.

Në fillim të muajit qershor, një ekip i RTK-së e ka përfaqësuar Televizionin në garën e reporterëve të mbajtur në Hungari. Majlinda Aliu - gazetare dhe Bedri Meha – kameraman, kanë qëndruar 5 ditë në Budapest, ku së bashku me 12 ekipe nga televizionet e tjera të rajonit kanë marrë pjesë në këtë garë sfiduese. Një pjesë e

shpenzimeve, gjegjësisht 80 % e shpenzimeve të udhëtimit, janë mbuluar nga organizatori “Reporter’s Cup”.

Një trajnim tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm në Gjermani në kuadër të Akademisë Verore Evropiane (CESA) organizuar nga CIRCUM dhe fondacioni “Robert Bosch”, u ndoq nga dy gazetarë që për herë të parë ndoqën një trajnim jashtë vendit (një e Programit të Mëngjesit dhe një e Dhomës së Lajmeve).

Të gjitha shpenzimet u mbuluan nga organizatorët, ndërsa kjo ishte një mundësi shumë e mirë për dy gazetarë të RTK-së, për të fituar përvojë ndërkombëtare në tri shtete evropiane, Gjermani, Francë e Itali.

Tri trajnime të tjera, dy jashtë Kosovës dhe një që u mbajt në ambientet e RTK-së, ishin pjesë e pakos së programit të EBU-së për të ndihmuar transmetuesit publikë.

Trajnimi i parë është mbajtur në Hamburg të Gjermanisë prej 16-19 qershor, me tematikë digjitalizimin e lajmeve, ku RTK-në e kanë përfaqësuar 2 pjesëmarrës, ndërsa trajnimi i dytë është mbajtur në Budapest të Hungarisë, ku RTK-ja gjithashtu dërgoi dy përfaqësues të saj.

Të gjitha shpenzimet e këtyre dy trajnimeve janë bartur nga EBU-ja. Trajnimi i tretë në kuadër të këtij programi, i cili u mbajt në Prishtinë, kishte për qëllim aftësimin e top-menaxhmentit dhe menaxherët e udhëheqësit e njësive të RTK-së për qeverisjen dhe menaxhimin e shërbimit publik.

Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 22 pjesëtarë të menaxhmentit të lartë dhe të mesëm të RTK-së.

Një përvojë e vitit 2010, që është për t’u veçuar nga të tjerat, është ajo e Albin Xharrës, montazher, i cili u përzgjedh në mesin e qindra konkurrentëve si trajner për videogazetari, në një projekt të CIRCUM-it, për të trajnuar personelin e Televizionit të Portugalisë. Pjesëmarrja e Albinut në një projekt si ky është një vlerësim profesional jo vetëm për të, por edhe për RTK-në në përgjithësi.

Organizuar nga OSBE-ja në dy trajnime kanë marrë pjesë 2 gazetarë nga Dhoma e Lajmeve e Televizionit.

Ndërsa janë mbajtur disa trajnime të brendshme për personelin e sigurimit të RTK-së, si reagimi në raste emergjente, mbrojtja nga zjarri etj.

Shtatë të punësuar kanë ndjekur trajnimin për Ligjin e Punës në Ohër të Maqedonisë, ndërsa një trajnim tjetër është ndjekur nga një e punësuar për menaxhimin e projekteve.

Gjithashtu, në vitin 2010, RTK është bërë pjesë e iniciativës për themelimin e Komitetit Rajonal të Trajnimeve. Në fund të muajit shtator, RTK ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Televizioni kroat në Zagreb, ku u vendos themelimi i Qendrës Rajonale të Trajnimeve.

Nga fundi i vitit, është punuar aktivisht për kompletimin e infrastrukturës së Qendrës për Aftësim Profesional në RTK.

Kjo qendër është pajisur me gjithë infrastrukturën e nevojshme, përfshirë dy zyra për mbajtjen e trajnimeve, monitorë, projektorë etj.

Dymbëdhjetë gazetarë-praktikantë janë trajnuar për më se 3 muaj në modulet bazë të gazetarisë televizive, si: të shkruarit për TV, gjuha standarde në televizion, moderimi, paraqitjet e drejtpërdrejta. Menaxhmenti ka caktuar një listë të trajnerëve të brendshëm për këto trajnime. Gjithashtu, në përputhje me Rregulloren për aftësim profesional të RTK-së është hartuar praktikumi.

Mirëpo, ende nuk ka vendim të nënshkruar për trajnerët dhe nuk ka politikë të qartë nëse do të duhej të vazhdohej sipas programit të paraparë me praktikum, pasi gazetarët-praktikantë tashmë janë angazhuar në raportim.

Në RTK, ka vazhduar tradita e pranimit të praktikantëve në Dhomën e Lajmeve në TV dhe në Radio nga Dega e Gazetarisë në UP dhe nga Universiteti AAB, me të cilët kemi marrëveshje të nënshkruar.

Tridhjetë studentë nga Dega e Gazetarisë e Universitetit të Prishtinës kanë kryer praktikën në Dhomën e Lajmeve, 151 studentë nga Dega e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë nga Universiteti AAB, si dhe 22 nxënëse nga Shkolla e Mesme Teknike në Prishtinë kanë ndjekur trajnim në sektorin e dizajnit dhe grafikës.

10. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Gjatë vitit 2010, duke iu referuar tabelës së prokurimit në Televizion dhe Radio, kemi pasur 923 kërkesa në Televizion dhe 115 në Radio. Prej këtyre kërkesave, në RTK janë gjithsej 52 kontrata të nënshkruara për shërbime, mallra dhe punë, të cilat u janë nënshtruar aktiviteteve të prokurimit për kontratat me vlerë të vogël, të mesme, të mëdha dhe pa publikim të njoftimit për kontratë (50 prej tyre në TV, 2 në Radio), derisa kontrata me vlera minimale janë gjithsej 106 (99 në TV dhe 7 në Radio), në të cilat kontrata janë të inkorporuara, në listën e kontratave me vlerë të madhe të mesme, të vogël, edhe ato me vlera minimale.

Departamenti i Prokurimit i ka katër punëtorë dhe drejtuesin e Departamentit.

11. REVIZIONI I BRENDSHËM

Revizioni i brendshëm i RTK-së sipas strukturës së gjertanishme organizative për të gjitha aktivitetet e tij ka bashkëpunuar me drejtorin e përgjithshëm.

Revizioni i brendshëm i RTK-së si edhe departamentet tjera ishte nën ndikimin e ndryshimeve që u bënë kah fundi i vitit 2009 dhe fillimi i vitit 2010.

Revizioni i brendshëm ka hartuar Draft Programin e punës sipas përshkrimit të vendit të punës së revizionit të brendshëm. Draft Programi i punës i është paraqitur drejtorit të përgjithshëm për plotësim eventual dhe për miratim në mbledhjet e menagjmentit, në mënyrë që pas miratimit të programit të informohet që të veprohet sipas tij apo të punohet sipas kërkesave për auditim të fushave të caktuara.

Në këtë raport paraqes aktivitetet e revizionit të brendshëm sipas kronologjisë:

- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga “Financial Law Smart Agency” Partneriteti Publiko Privat, Koncesionet dhe Prokurimi Publik të mbajtur nga data 25 – 28 shkurt 2010 në Durrës Shqipëri.
- Me kërkesën e Drejtorit të përgjithshëm është bërë Revizioni i tenderit të shpallur për Furnizimin me Kaseta gjer në fazën e para nënshkrimit të kontratës. Revizioni është kryer në periudhën prej 12/04 – 16/04/ 2010.
- Pjesëmarrja në trajnimin “Menaxhimi i Përformancës në Prokurimin Publik dhe Auditimi” nga data 25 – 28 Nëntor 2010 në Vlorë Shqipëri.
- Roli i Ligjit të Ri të Punës në Rregullimin e Marrdhënjëve të Punës Në Republikën e Kosovës nga 02- 05 dhjetor 2010 në Ohër Maqedoni.
- Instituti Kosovar për Menaxhimi ka organizuar trajnimin mbi „ Kontrollin e brendshëm dhe Auditimin,, nga 16 – 19 dhjetor 2010 në Ohër Maqedoni.

Gjatë gjithë vitit raportues janë sugjerime dhe këshilla në kuadër të departamenteve që kanë bërë pyetje për probleme të caktuara si dhe janë përcjell ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe është bërë përcjellja e rregulloreve të brendshme për me qenë përherë në njohuri për zbatimin e tyre kur do që bëhet revizioni.

12. FINANCAT

Të hyrat primare të RTK-së në vitin 2010 janë nga Buxheti i Kosovës.

Shpenzimet që RTK-ja ka bërë gjatë vitit 2010 janë më të ulëta se të hyrat që ka realizuar gjatë këtij viti. Shpenzimet në RTK iniciohen dhe realizohen në bazë të procedurave të shkruara, gjë që mundëson kontrollin, arsyeshmërinë dhe mbikëqyrjen permanente të shpenzimeve, të cilat krijohen në RTK gjatë vitit.

Që nga viti 2002, RTK-ja ka themeluar Zyrën e prokurimit, me tre punëtorë profesionalë të punësuar pranë kësaj Zyre, të cilët në harmoni me rregulloret në fuqi, i mbikëqyrin dhe zbatojnë në mënyrë strikte procedurat e prokurimit.

Që nga viti 2006, RTK-ja ka punësuar Auditorin e Brendshëm, i cili në harmoni me Rregulloret dhe procedurat në fuqi, e bën mbikëqyrjen dhe auditimin e brendshëm të afarizmit të RTK-së.

Nga 1 Tetori 2009, RTK-ja ka dalë krejtësisht nga parapagimi me vendim të Gjykatës Kushtetuese duke u fokusuar në financim nga Buxheti i Kosovës, si burim i perkohshëm i financimit.


Gjatë vitit 2010, RTK-ja ka ndërmarrë një sërë masash, në drejtim të zvogëlimit maksimal të shpenzimeve, gjë që ka rezultuar që RTK-ja ta përmbyll vitin financiar 2010 me një bilanc pozitiv prej 1,081,293€.

12.1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET E RTK-SË PËR VITIN 2010

12.1.1. Të hyrat

Të hyrat kryesore të RTK-së në vitin 2010, kanë qenë nga buxheti i Kosovës e që përbëjnë 85% të të hyrave të përgjithshme të RTK-së. Të hyrat nga marketingu kanë gjeneruar 14% të të hyrave të përgjithshme. Të hyrat nga ri-mbursimet dhe të gjitha të hyrat e tjera kanë qenë 1% të të hyrave të përgjithshme.

Në vazhdim, në formë të grafikonit do të paraqesim strukturën e të hyrave të RTK-së gjatë vitit 2010:




12.1.2. Shpenzimet

RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe synon të ofrojë shërbime që kanë vlerë më të madhe sesa mjetet e shpenzuara.

Kontabiliteti udhëhiqet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në harmoni me Rregulloret përkatëse, që janë në fuqi. Departamenti i Financave i RTK-së, veç raportit vjetor, përpilon edhe raporte financiare tre mujore, të cilat rregullisht analizohen dhe shqyrtohen në Menaxhmentin e RTK-së dhe aprovohen nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së. Ekzistojnë politika të shkruara financiare dhe procedura strikte të kontrollit të shpenzimeve. Asnjë shpenzim nuk mund të lejohet dhe paguhet pa aprovimin paraprak me shkrim të së paku dy personave të autorizuar. Pagesat e pagave të punëtorëve të rregullt, të atyre me kontratë mbi vepër dhe honoraret, bëhen përmes llogarisë bankare, ashtu si dhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve. Pagesat në para të gatshme bëhen vetëm në raste të veçanta dhe të domosdoshme dhe vetëm në shuma të vogla. Pagesat e mëditjeve për udhëtime zyrtare, brenda dhe jashtë vendit, bëhen në bazë të Rregullores së shkruar.

Në fund të çdo viti a farist, RTK-ja formon komisione t për regjistrim (inventarizim) të pasurisë, aseteve, mjeteve të gatshme dhe kërkesave e obligimeve. Komisionet, pas regjistrimit, bëjnë barazimin e gjendjes së konstatuar me regjistrim, me gjendjen në kontabilitet dhe i përpilojnë raportet përkatëse mbi gjendjen e konstatuar. Këto raporte shqyrtohen nga ana e Komisionit Qendror dhe sipas nevojës, nga ana e Menaxhmentit të RTK-së. Vendimet e marra nga ana e Komisionit Qendror apo/dhe Menaxhmentit domosdoshmërisht zbatohen më tej me regjistrimet përkatëse në evidencën e kontabilitetit të RTK-së.

Në vazhdim, në formë të grafikonit, do të paraqesim strukturën e shpenzimeve të RTK-së për vitin 2010:



Në vazhdim në formë tabelare, do të paraqesim Pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2010 sipas standardeve nderkombëtare të kontabilitetit:

- 1) Bilanci i gjendjes,
- 2) Pasqyra e të ardhurave,
- 3) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet,
- 4) Pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe
- 5) Shpalosja e pasqyrave financiare

Radio Televizioni i Kosovës		
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010		
1) Bilanci i gjendjes		
	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo qarkulluese		
Prona, impiantet dhe pajisjet	2,475,826	2,769,981
Pasurit e patrupzuara-Serialet	2,577,509	1,871,442
Totali i pasuritë jo qarkulluese	5,053,335	4,641,423
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet e materialit shpenzues	38,092	261,728
Llogarite e arketueshme dhe të tjera	1,153,417	1,451,687
Shpenzimet e parapaguara	207,183	98,310
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	538,093	124,773
Totali i pasuritë qarkulluese	1,936,785	1,936,498
Totali i pasurive	6,990,120	6,577,921
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Ekuiteti		
Kapitali Shoqëror	8,224,255	8,224,255
Deficiti i Akumuluar	(3,258,089)	(1,007,071)
Suficiti/ Deficiti i vitit	1,081,293	(2,251,018)
Totali i ekuitetit	6,047,458	4,966,166
Detyrimet		
Detyrimet jo qarkulluese		
Detyrimet afatgjata	166,757	266,265
Totali i detyrimet jo qarkulluese	166,757	266,265
Detyrimet qarkulluese		
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	673,178	1,266,528
Tatimet e pagueshme	102,727	78,963
Totali i detyrimet qarkulluese	775,905	1,345,491
Totali i detyrimeve	942,662	1,611,756
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve	6,990,120	6,577,921
Bordi i Radio Televizionit të Kosovës ka aprovuar këto pasqyra financiare me datën _____ dhe janë nënshkruar nga Menaxhmenti i RTK-së:		
Sylejman Shaqiri		Bujar Spahiu
Drejtor i Përgjithshëm		Drejtor Financiar

Radio Televizioni i Kosovës		
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010		
2) Pasqyra e të ardhurave		
	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Të ardhurat nga parapagimi	0	7,080,276
Të ardhurat nga buxheti i Kosovës	10,464,000	
Të ardhurat nga marketingu	1,733,817	2,540,445
Të ardhurat tjera	107,345	164,321
Gjithsejt të ardhurat	12,305,162	9,785,042
Shpenzimet e pagave	4,394,943	4,264,454
Shpenzimet e zhvlersimit	1,396,092	1,409,765
Shpenzimet e pergjithshme (Programi)	5,432,833	5,387,802
Shpenzimet nga provizionimi i borxheve të këqija		1,826,005
Gjithsejt shpenzimet operacionale	11,223,869	12,888,025
Suficiti/ Deficiti operativ	1,081,293	(3,102,984)
Të ardhurat nga provizionimi i detyrimeve		851,966
Suficiti/ Deficiti i vitit	1,081,293	(2,251,018)

Radio Televizioni i Kosovës			
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010			
3) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet			
	Kapitali shoqëror	Suficiti/ Deficiti i mbartur	Totali i ekuitetit
Bilanci me 1 Janar 2009	8,224,255	(1,007,071)	7,217,184
Suficiti i vitit			
Deficiti i vitit		(2,251,018)	(2,251,018)
Bilanci me 31 Dhjetor 2009	8,224,255	(3,258,089)	4,966,165
Bilanci me 1 Janar 2010	8,224,255	(3,258,089)	4,966,165
Suficiti i vitit		1,081,293	
Deficiti i vitit			
Bilanci me 31 Dhjetor 2010	8,224,255	(2,176,797)	6,047,458

Radio Televizioni i Kosovës		
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010		
4) Pasqyra e rrjedhës së parasë		
	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivitetet Operative		
Suficiti/ Deficiti i vitit	1,081,293	(2,251,018)
<i>Përshtatur për:</i>		
Zhvierësimin	1,396,092	1,409,765
Provizionet për borje të këqija		1,826,005
Të hyrat nga provizionimet e detyrimeve		(851,966)
Shlyrja e kërkesave		(188,175)
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapital punues</i>	2,477,385	(55,389)
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Stoqet	(223,635)	(37,438)
Të arkëtueshmet tjera tregtare	413,033	1,838,012
Detyrimet tjera dhe tregtare	(569,586)	237,668
	(380,188)	2,038,242
Aktivitetet Investuese		
Blerja e pronës, impiantevet dhe pajisjeve	(282,295)	(722,079)
Blerja e pasurive të patrupzuara	(1,302,076)	(1,336,406)
	(1,584,370)	(2,058,486)
Aktivitetet Financuese		
Kredi aftagjate	(99,508)	146,774
	(99,508)	146,774
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalentët e parasë		
	413,319	71,141
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim te vitit	124,773	53,632
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund te vitit	538,093	124,773

5) Shpalosjet e pasqyrave financiare

1. Shenime per gjendjen dhe levizjen e asetëve

Përshkrimi	Paisjet për transmetim	Automjetet	Paisje dhe kompjuterat	Inventari	Totali
Kosto					
Me 01 Janar 2009	7,603,035	304,341	289,630	228,386	8,425,392
Blerjet gjatë vitit	84,643	231,810	144,894	271,732	733,079
Me 31 Dhjetor 2009	7,687,678	536,152	434,523	500,118	9,158,472
Zhvlerësimi i Akumuluar					
Me 1 Janar 2009	(5,451,200)	(127,413)	(133,975)	(107,942)	(5,820,530)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(442,073)	(39,249)	(41,591)	(45,049)	(567,962)
Me 31 Dhjetor 2009	(5,893,273)	(166,662)	(175,565)	(152,991)	(6,388,492)
Vlera neto					
Me 1 Janar 2009	2,151,835	176,928	155,655	120,444	2,604,862
Me 31 Dhjetor 2009	1,794,405	369,489	258,958	347,127	2,769,980
Kosto					
Me 01 Janar 2010	7,687,678	536,152	434,523	500,118	9,158,472
Blerjet gjatë vitit	190,056	0	55,788	36,450	282,295
Me 31 Dhjetor 2010	7,877,735	536,152	490,311	536,569	9,440,766
Zhvlerësimi i Akumuluar					
Me 1 Janar 2010	(5,893,273)	(166,662)	(175,565)	(152,991)	(6,388,492)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(374,933)	(73,898)	(53,777)	(73,840)	(576,448)
Me 31 Dhjetor 2010	(6,268,206)	(240,560)	(229,343)	(226,831)	(6,964,940)
Vlera neto					
Me 1 Janar 2010	1,794,405	369,489	258,958	347,127	2,769,980
Me 31 Dhjetor 2010	1,609,528	295,592	260,969	309,738	2,475,826

2. Pasurit e patrupzuara						
Përshkrimi	Familja moderne	Kafeneja Jone	Oksigjeni	Frekuenca e quzes	Te tjera dhe materiali në arhivë	Totali
Vlera neto me 01 Janar 2009	374,568.78	637,566.12	121,829.72	110,938.65	367,225.60	1,612,128.87
Blerjet gjatë vitit	283,236.00	546,000.00	427,148.92	13,624.00	92,835.02	1,362,843.94
Zhvlerësimi gjatë vitit	(189,935.45)	(365,365.00)	(277,646.46)	(8,856.00)		(841,802.91)
Vlera neto me 31 Dhjetor 2009	467,869.33	818,201.12	271,332.18	115,706.65	460,060.62	2,133,169.90
Vlera neto me 01 Janar 2010	467,869.33	818,201.12	271,332.18	115,706.65	460,060.62	2,133,169.90
Blerjet gjatë vitit	217,476.00	578,969.81	464,545.24		41,084.46	1,302,075.51
Zhvlerësimi gjatë vitit	(141,359.40)	(376,330.38)	(301,954.40)			(819,644.18)
Vlera neto me 31 Dhjetor 2010	543,985.93	1,020,840.55	433,923.02	115,706.65	501,145.08	2,615,601.23

3. Llogarit e arktueshme dhe te tjera		
	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
3.1 Llogarit e arktueshme	55,164	588,907
3.2 Kërkesat tjera	110,424	166,109
3.3 Parapagimet	209,861	98,310
3.4 Kerkesat për TVSH	984,107	696,671
	1,359,556	1,549,997
3.1 Llogarit e arktueshme		
	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Llogarit e arktueshme- Kek-u	1,701,753	2,223,970
Provizioni per borgje te kqija dhe te dyshimta-Keku	(1,701,753)	(1,701,753)
Kerkesat nga klientat-Marketing (me kompenzim)	97,317	110,913
Kerkesat nga marketingu	42,271	42,490
Kerkesat ndaj transmetuesve	40,388	39,847
Provizioni per borgje te kqija dhe te dyshimta	(124,813)	(126,559)
	55,164	588,907
Levizjet në provizionin për borxhe të këqija		
	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Bilanci me 1 Janar	(1,828,312)	(190,482)
Të provizionuara gjatë vitit		(1,826,005)
Shlyerjet gjatë vitit		188,175
Bilanci me 31 Dhjetor	(1,828,312)	(1,828,312)
3.2 Kerkesat tjera		
	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Kerkesat ndaj donatoreve	10,358	10,358
Kerkesat nga shfrytzesit e objektit	87,318	136,182
Kerkesat ndaj arkivit	120	120
Kerkesa tjera	12,627	19,449
	110,424	166,109

3.3 Parapagimet			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Avanset për punetorë		2,678	
Parapagimet- Furnitoret e jashtem		204,715	97,843
Parapagimet- Furnitoret e vendit		2,468	468
		209,861	98,310
4. Paraja			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Llogaria bankare		401,403	
Llogaria bankare- Televizion		134,514	124,638
Llogaria bankare- Radio		2,108	
Arka kryesore TV			
Arka kryesore Radio		67	135
		538,093	124,773
5. Llogarit e pagueshme dhe te tjera			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
5.1 Detyrimet ndaj furnitoreve		1,485,977	1,195,669
5.2 Detyrime tjera		23,187	35,890
5.3 Detyrimet ndaj klientve		9,813	34,969
		1,518,978	1,266,528
5.1 Llogarit e pagueshme-Detyrimet ndaj furnitoreve			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Obligimet ndaj marketingut		107,694	110,208
Furnitoret -persona Juridik		926,757	906,978
Furnitoret- ne vend		376,117	696,887
Furnitoret jasht vendit		75,408	331,134
Provizionimi Illogarive te pagueshme			(849,538)
		1,485,977	1,195,669

5.2 Detyrimet tjera			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Obligimet ndaj sigurimeve shendetsore		11,638	20,764
Obligimet për paga		2,228	5,450
Obligime për punëtor		9,248	8,487
Obligimet ndaj honorareve			1,099
Obligime te tjera		73	90
		23,187	35,890
6. Detyrimet ndaj tatimeve dhe kontributeve			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Detyrime per tatimin ne paga- Stafi i rregullt		28,395	20,281
Detyrime per tatimin ne paga- Stafi sekundar		8,372	10,910
Detyrime ndaj kontributeve pensionale-Punedhensi		27,153	23,919
Detyrime ndaj kontributeve pensionale-Punetori		27,153	23,853
		91,073	78,963
7. Shpalosja e te hyrave nga sherbimet			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Të hyrat nga Buxheti i Kosovës		10,464,000	
Të hyrat nga KEK-u (PEP)			7,080,276
Të hyrat nga marketingu		473,438	737,381
Te hyrat nga urimet		3,377	6,945
Të hyrat nga sponsorizimet		1,260,379	1,803,063
Te hyrat nga vendosja e antenes		26,764	24,389
Te hyrat nga transmetimet		25,763	19,631
Te hyrat nga parkingu		11,405	13,664
Te hyrat nga zhfrytzimi i lokaleve		25,601	48,044
Te hyra tjera		14,435	51,649
		12,305,162	9,785,042

8. Shpalosja e shpenzimeve			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Shpenzimet e furnizimit të materialit		56,127	46,896
Shpenzimet e energjis elektrike		85,210	78,006
Shpenzimet per uj dhe mbeturina		43,202	36,103
Meditjet e Bordit		97,396	51,067
Reforma, arsimimi dhe trajnimi		17,927	12,637
Shpenzime per perkthime dhe sinkronizime		27,631	34,562
Sherbimet kontraktuese- Korrespondentet		275,309	265,717
Big Band i RTK-së		73,540	76,740
Shpenzimet per telefon		95,479	107,701
Shpenzimet per internet dhe Web faqe		28,306	25,727
KTTN(Rrjeti I transmetimit territorial të Kosovës)		40,425	40,026
Shpenzimet tjera për udhëtim zyrtar		46,115	19,627
Shpenzimet e medijtjeve		75,928	96,628
Shpenzimet e udhëtimit- Biletat		37,706	32,614
Shpenzimet per karburante		102,377	81,081
Mirmbajtja e automjeteve		35,804	45,041
Mirmbajtja e pajisjeve		50,468	57,891
Renovimi		18,474	
Provizini ndaj Kek-ut			424,817
Provizioni i marketingut		207,572	368,090
Provizioni bankar		6,787	8,557
Shërbimet mjeksore		9,862	9,000
Tatimi në pronë		19,367	17,293
Shpenzimet operacionale te Bordit		12,785	12,559
Shpenzimet per licenc- KPM		27,568	30,834
Mikpritja për musafirë		24,163	24,967
Kontrata me EBU dhe Fidat		136,028	123,418
Shpenzimet tjera- Sateliti		183,143	182,400
Shpenzime të ndryshme		44,046	48,522
5% nga parapagimi për zyren e kryeministrit			329,419
Shpenzimet per shpalljet		35,815	109,458
Shpenzimet per programe		2,475,402	1,854,092
Shpenzimet per drejtat e sportit		617,217	483,314
Shpenzimet per skenografi		92,770	28,098
Parapagimi për Kosova Live & Kosova Press		25,127	14,040
Programi i vitit të ri		73,757	94,859
Produksionet e pavarura (20%)		234,000	116,000
		5,432,833	5,387,802

9. Shpenzimet e pagave			
		Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Pagat e punëtorëve të rregullt		3,373,945	3,076,348
Paga me kontrata njëvjeqare		268,736	483,246
Pagat e kontraktuara- Menaxhmenti		140,780	101,900
Shpenzimet e sigurimit shëndetsor- Punëdhenësi		64,539	30,557
Shpenz. E kontributeve në ngarkesë të punëdhenësit		256,912	251,539
Shtesat- Kontrata Kolektive		290,031	320,863
		4,394,943	4,264,454